

1 E mërkurë, 6 dhjetor 2023

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 09.01

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Z.

6 Roberts.

7 Z. ROBERTS: [Përkthim] Mirëmëngjes. Shkurtimisht përpara  
8 se të filloj dëshmitari. Po vrisja mendjen lidhur me vendimin  
9 që nxorët të premtën, e di që ka ngritur një problem kolegu,  
10 z. Kehoe, për kushtet e paraburgimit.

11 Vërejmë që vendimi juaj ende nuk është zbatuar, a mund të  
12 na thotë diçka Zyra Administrative kur do të zbatohet ky  
13 vendim edhe çfarë problematikash ka pasur për ta vonuar kaq  
14 shumë zbatimin.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E takuam dje  
16 Zyrën Administrative, po bëjnë të pamundurën që ta zbatojnë  
17 këtë urdhër. Sa i takon telefonatave nga familja ato mund të  
18 kryhen, po do të monitorohen derisa të dalë një urdhër i ri.

19 Z. ROBERTS: [Përkthim] E kuptoj, por ama nuk kanë folur  
20 që të dielën. Të dielën ka qenë telefonata e fundit.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pyeta dje dhe  
22 Administratorja më tha dje thjesht duhet të bëjnë një kërkesë  
23 dhe do ta lejojnë.

24 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

25 Z. ROBERTS: [Përkthim] Po a e dimë kur do zbatohet pjesa

1 e mbetur e vendimit?

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Unë po  
3 mundohem të kujtoj çka thashë tani. Po besoj brenda javës  
4 tjetër. Po bëjnë organizimet e nevojshme dhe ta prezantojnë që  
5 t'i kuptojnë të gjithë aspektet administrative të kësaj  
6 situate të re. Janë duke punuar do të zbatohet shumë shpejt.  
7 Datën fikse nuk ta jap dot, por e di që synojnë që të  
8 realizojnë apo ta zbatojnë përpara pushimit të Krishtlindjeve.

9 Z. ROBERTS: [Përkthim] Mirë. Po do kem korrespondencë me  
10 Zyrën Administrative që të jem më i informuar dhe të kuptoj se  
11 çfarë do të ndodhë.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju thashë  
13 edhe një herë telefonatat private lejohen, por për momentin do  
14 të monitorohen.

15 Z. ROBERTS: [Përkthim] Jo, e kuptoj këtë. E kuptoj.

16 Z. EMMERSON: [Përkthim] A mund të them dhe unë diçka nga  
17 ana e Veselit?

18 Janë bërë disa kërkesa për telefonata me anëtarët e  
19 familjes dhe janë refuzuar aktualisht. Pra, deri tani nuk u  
20 janë lejuar telefonatat me familjen, qofshin dhe këto të  
21 monitoruara.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Okej. Do ta  
23 shikoj dhe këtë punë.

24 Z. KEHOE: [Përkthim] Kam dhe unë nevojë të mbështesë atë  
25 që tha z. Emmerson sa i takon klientit tim. Nuk i janë lejuar

1 telefonatat.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull. E  
3 kuptoj. Mbase ka pasur ndonjë keqkuptim dhe unë i kërkoj  
4 ndjesë për këtë, por do ta trajtoj unë këtë aspekt, këtë  
5 çështje, gjatë ditës së sotme.

6 [Trupi Gjykes dhe Sekretarja e Gjykatës  
7 këshillohen]

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sekretarja e  
9 Gjykatës, tani mund të paraqesë lëndën.

10 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar  
11 Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i  
12 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep  
13 Selimit dhe Jakup Krasniqit.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vërej që të  
15 gjithë të akuzuarit janë të pranishëm fizikisht në sallën e  
16 gjyqit.

17 Asistente e Sallës, ju lutem sillni dëshmitaren.

18 [Dëshmitarja vijon dëshminë]

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjesi,  
20 Dëshmitare.

21 DËSHMITARI: [Përkthim] Mirëmëngjes.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të vijojmë  
23 sot me pyetjet e Prokurorisë. Ju rikujtoj t'u përgjigjeni  
24 pyetjeve qartë, me fjali të shkurtra. Nëse nuk e kuptoni  
25 pyetjen, lirisht kërkoni që pyetja të përsëritet ose thoni që

1 nuk e kuptoni dhe ata do ta sqarojnë pyetjen për ju.

2 Gjithashtu, mos harroni të thoni ku e bazoni njohurinë  
3 për faktet dhe rrethanat për të cilat do t'ju bëjnë pyetje.

4 Ju kujtoj se jeni ende nën betim për të thënë të vërtetën  
5 sikurse vetë e cituat përmes deklaratës solemne.

6 Flisni afër mikrofonit dhe prisni pesë sekonda përpara  
7 se të përgjigjeni pyetjeve dhe flisni ngadalë në mënyrë që  
8 t'ju ndjekin dhe përkthyesit.

9 Nëse keni nevojë për pushime, na e thoni do bëjmë  
10 organizimet e nevojshme.

11 Prokurore. Fjala është për ju.

12 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Faleminderit.

13 DËSHMITARJA: SANDRA MITCHELLIN [Vijon]

14 [Dëshmitarja përgjigjet përmes përkthimit]

15 Pyetje nga znj. Mayer: [Vazhdim]

16 ZNJ. MAYER: [Përkthim]

17 PY. Mirëmëngjesi, Dëshmitare.

18 PË. Mirëmëngjes

19 PY. Dje po flisnim për "Siç është parë, siç treguar" vëllimi  
20 1, për këtë raport.

21 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Do lutesha që të shfaqej në ekran  
22 materiali SITF00001529 deri në -- ju kërkoi ndjesë edhe  
23 njëherë, SITF0001871, duhet të shikojmë faqen 1585.

24 PY. Shohim faqen tek pika (c), "Intimidimi apo ngacmimi i  
25 shqiptarëve të Kosovës" ka "një atmosferë të përgjithshme

1 frike dhe frikësime që nuk mund të kufizohen në një komunitet  
2 të vetëm, është e përhapur. Nuk janë prekur të gjithë  
3 shqiptarët e Kosovës, por disa grupe të popullatës është e  
4 qartë që ndihen të pasigurt”.

5 “Një grup i shënjestruar duket të jenë anëtarët e LDK-  
6 së”.

7 A mund të na thoni konstatimet tuaja lidhur me këtë në  
8 kohën që keni qenë në Kosovë, flasim për periudhën kohore të  
9 këtij raporti që është qershor deri tetor i vitit 1999?

10 PË. Më kujtohet që LDK-ja ka qenë partia e fundit e zgjedhur  
11 politike në Kosovë nga zgjedhjet e fundit që kishin ndodhur  
12 para ca kohësh. Kishin shumë poste burokratike në  
13 administratat paralele që këtë e kryesonte z. Rugova, si  
14 kryetar i LDK-së aso kohe.

15 Kishin praktikuar, pra, kishin pasur rezistencë ndaj  
16 autoriteteve serbe për shumë vite dhe është e drejtë të themi,  
17 ose të paktën ishte përshtypja ime, që kishte anëtarë të UÇK-  
18 së në komunitet që ishin të zemëruar nga fakti që s’kishte  
19 progres, s’ishte bërë progres saç duhet për të dëbuar serbët  
20 nga Kosova.

21 Pas rifutjes në Kosovë pas ndërhyrjes së NATO-s morëm  
22 raporte të shumta - një ishte, për shembull, për zonën e  
23 Gjilanit - ku përfaqësitë e LDK-së apo anëtarët e LDK-së ishin  
24 të shenjestruar, i ngacmonin, i frikësonin anëtarët e UÇK-së  
25 që përpiqeshin të përmbushnin hapësirën politike që kishte

1 zënë LDK-ja.

2 PY. Shkojmë te pika numër 5, ku thuhet "Ndalimi dhe arrestimi  
3 arbitrar" dhe këtu tregon sesi UÇK-ja nuk kishte kompetenca të  
4 ligjshme për të arrestuar persona, se OSBE-ja dhe ju, kishit  
5 marrë raporte të shumta lidhur me burra të veshur me uniforma  
6 të UÇK-së ose të paktën që e identifikonin veten si anëtarë të  
7 UÇK-së dhe dukej se kishte një praktikë të arrestimit dhe  
8 ndalimit arbitrar, ndonjëherë këto shoqëroheshin edhe me  
9 keqtrajtim. Edhe këtu është vetë e qartë periudha kohore.

10 "Është qershor, tetor".

11 Folëm pak shkurtimisht për këtë dje. Folëm për raportet e  
12 shumta që keni marrë për të gjithë Kosovën që në mënyrë  
13 konsistente e përshkruanin UÇK-në apo individë të UÇK-së, me  
14 uniforma të UÇK-së --

15 Z. KEHOE: [Përkthim] Kundërshtoj.

16 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Po përpiqem ta orientoj, t'i jap  
17 kontekstin dëshmitares. Që të kuptojë për çfarë po flisnim  
18 dje.

19 Z. KEHOE: [Përkthim] A është kjo një pyetje?

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni.

21 ZNJ. MAYER: [Përkthim]

22 PY. Ju lutem të shkojmë në kreun e faqes së radhës. Thuhet  
23 që:

24 "Rasti i parë i raportuar ka qenë data 19 qershor ..."

25 A mund të na thoni kur ka ndodhur kjo pas hyrjes suaj në

1 Kosovë?

2 PË. Rreth një javë pasi kemi hyrë në Kosovë ka ndodhur.

3 Qershori i 1999.

4 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Vetëm për sqarim. Ju thatë në  
5 krye të faqes tjetër a mund të na thoni për cilën faqe e keni  
6 fjalën? Se nuk po e shohim për momentin.

7 ZNJ. MAYER: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar]. Është  
8 faqja tjetër në dokument SITF0001586.

9 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Po shoh datën. Data 19 e pashë.  
10 Faleminderit.

11 ZNJ. MAYER: [Përkthim]

12 PY. Titulli tjetër është "Vlerësim", lexon "Vlerësim". A mund  
13 ta lexoni këtë paragraf ku flitet për "përfshirjen e  
14 pretenduar të UÇK-së si një element konsistent, veçanërisht në  
15 fillim të periudhës së raportimit". Ju thoni "në fillim" të  
16 periudhës së raportimit, për cilën periudhë e keni fjalën?

17 PË. Unë jam rikthyer në Kosovë diku në qershor, 10 qershor  
18 mbase a 13 qershor, se s'më kujtohet tamam. Kështu që 19  
19 qershor i bie të jetë java pasardhëse ose një javë pasi kishim  
20 hyrë.

21 PY. A e kuptoj dhe në pjesën tjetër të paragrafit flitet për  
22 serbët e Kosovës këtu po flitet dhe për shqiptarët e Kosovës  
23 të përfshirë apo të ndaluar nga UÇK-ja.

24 A mund të na tregoni diçka për këtë vlerësim të shprehur  
25 në këtë paragraf si ishin prekur serbët e Kosovës dhe si ishin

1 prekur shqiptarët e Kosovës?

2 PË. Sigurisht që kishte më shumë ngacmime, frikësim, ndaj  
3 pakicave, pakicat e ndjenin më shumë këtë në Kosovë që solli  
4 dhe largimin e shumve. Por në kohën që ne u kthyem, kishte një  
5 ndjesi frike, që i pengonte shqiptarët e Kosovës të merrnin  
6 pjesë në procese publike, në aspekte ndëretnike dhe në  
7 përgjithësi kjo ndikonte, kishte ndikim te shqiptarët e  
8 Kosovës që ose nuk e mbështesnin UÇK-në ose që perceptoheshin  
9 si persona që nuk e mbështesnin UÇK-në.

10 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Në të njëjtin dokument shkojmë tek  
11 faqja SITF0001597. Shohim pjesën e dytë të kësaj faqeje që  
12 është "Praktika e Të Drejtave të Njeriut ...".

13 PY. Shohim fjalinë e dytë ku flitet për:

14 "Grupet, për pakicat që akuzoheshin për bashkëpunime  
15 forcat jugosllave dhe serbe ...".

16 Folëm shkurtimisht dje për bashkëpunëtorët. Ju lutem  
17 lexoni këto fjali dhe shpjegojini Trupit Gjykues diçka lidhur  
18 me akuzat për bashkëpunim edhe frikën nga shpagimi,  
19 pavarësisht nëse ka pasur apo s'ka pasur në të vërtetë  
20 bashkëpunim.

21 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Përpara se të përgjigjet  
22 Dëshmitarja, a mund të na thoni dhe bazën e këtij përfundimi  
23 se nuk ka ndonjë të cituar të këtillë në këtë paragraf për të  
24 mbështetur këtë dëshmi opinion.

25 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Besoj se dëshmitarja dje po



1 shpjegonte metodologjinë e raportit dhe tha se ishte e bazuar  
2 në punën e saj, në punën e ekipit të saj dhe i kishin  
3 verifikuar burimet. Unë me kënaqësi mund ta pyes edhe  
4 dëshmitaren edhe për poshtëshënimet.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet  
6 kundërshtimi.

7 Vazhdoni.

8 ZNJ. MAYER: [Përkthim]

9 PY. Mund t'i përgjigjeni pyetjes.

10 PË. Gjatë kohës sime në Kosovë si para ndërhyrjes së NATO-s  
11 dhe më pas dhe, mesa kuptoj, këtu bëhet fjalë për periudhën  
12 pas ndërhyrjes, shqiptarët e Kosovës që mund të ishin mbase  
13 miq ose kishin pasur shokë serbë apo fqinjë që ishin pjesë e  
14 pakicave, këta persona konsideroheshin "kolaboracionistë" edhe  
15 ajo ashpërsia që përdorej nga UÇK-ja dhe targetoheshin,  
16 shënjestroheshin nga UÇK-ja dhe mbështetësit e tyre aso kohe.

17 PY. Pra, kjo është ajo që keni dashur të thoni ju kur thoni  
18 në raport se pavarësisht nëse ishin fajtorë apo jo, ata  
19 konsideroheshin si kolaboracionistë, perceptoheshin si  
20 kolaboracionistë?

21 PË. Po.

22 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Të vendosim në ekran dokumentin  
23 që mban numrin 013312 deri në 01334 RED dhe shkojmë në faqen  
24 013325.

25 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Ndjesë, po kjo ndodhë në mënyrë

1 të vazhdueshme dhe dje. Dëshmitarja nuk është dëshmitare e  
2 rregullës 154. Nuk kemi dijeni pse kërkon Prokurorja të shfaqë  
3 këto deklarata, t'i rifreskojë kujtesën apo të diskretitojë se  
4 kjo po ndodhë në mënyrë të vazhdueshme. Ju lutem na sqaroni në  
5 lidhje me këtë.

6 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Me kënaqësi mund t'ju përgjigjem.  
7 Patët dhe kundërshtime dje se thatë që nuk jeni shumë  
8 konkrete, kështu që unë përpiqem ta ndihmojë Prokuroren [sipas  
9 përkthimit] të japë kontekstin sepse u kundërshtuat konkretin.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në fakt, o po  
11 ndiqni rregullin 154 ose nuk po e ndiqni këtë rregull dhe  
12 është e qartë që nuk jeni objekt i rregullës 154. Kështu që  
13 pyetjen bëheni në mënyrë të drejtpërdrejtë. Nëse keni nevojë  
14 t'i rifreskoni kujtesën, atëherë thoni dua t'i rifreskoj  
15 kujtesën.

16 Z. KEHOE: [Përkthim] Sa i takon rregullit për rifreskimin  
17 e kujtesës, ka dhe një rregull tjetër dhe Prokurorja tha më  
18 lejoni t'i rifreskoj kujtesën tuaj dhe nuk i bëri asnjë  
19 pyetje.

20 Po dëshmitarja mund të thotë "Nuk më kujtohet" dhe ajo  
21 mund t'i thotë "Mirë, ua rifreskoj unë kujtesën" e le t'i  
22 tregojë më pas deklaratën.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E qartë.

24 Vazhdoni.

25 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Atëherë le ta heqim këtë dokument

1 nga ekrani në vijim të kundërshtimeve tuaja.

2 PY. Dëshmitare, ju po flisnit për serbët, fqinjët serbë me  
3 fqinjët shqiptarë.

4 A ju kujtohen raste kur serbët që kishin mbrojtur  
5 komshinjtë e tyre shqiptarë ishin objekt shpagimi në periudhën  
6 kur ju u kthyet në periudhën e qershorit 1999?

7 PË. Po.

8 PY. Na thoni çfarë ju kujtohet.

9 PY. Zona gjeografike që më kujtohet ka qenë zona e Prizrenit  
10 ku anëtarët e zonës, pakicës së zonës së Dragashit me sllavët  
11 mysliman kishin qëndruar gjatë fushatës së NATO-s dhe na  
12 raportuan se ishin kujdesur ose për tokën e fqinjëve apo për  
13 gjënë e gjallë apo për kulturën e tyre bujqësore, ishin  
14 përpjekur t'i mbronin fqinjët e tyre shqiptarë në një farë  
15 mënyre.

16 Pas konfliktit kur u kthyen të tjerët, këta persona - dhe  
17 kjo është e reflektuar në raportin e Prizrenit - dhe filluan  
18 të raportnin që i ngacmonin komuniteti i shqiptarëve të  
19 Kosovës, jo domosdoshmërisht fqinjët e tyre. Ne shkua  
20 personalisht në disa raste ku disa të moshuar serbë në atë  
21 zonë ishin vrarë, ishin ekzekutuar dhe ishte e qartë që këta  
22 persona të caktuar, në fakt, nuk kishin bërë asgjë për të qenë  
23 viktima shpagimi apo hakmarrjeje.

24 PY. Lidhur me këta persona, a morët ndonjëherë raporte a  
25 kishte ndodhur nga anëtarët lokalë të UÇK-së apo nga UÇK-ja që

1 vinte nga pjesë të tjera të vendit apo nga komunitete të  
2 tjera?

3 PË. Shpesh ishin shqiptarë të Kosovës që nuk ishin të atij  
4 komuniteti, nuk i njihnin. Fshatrat ishin shumë të vegjël dhe  
5 është krejt normale që njerëzit e njohin njeri-tjetrin dhe  
6 familjarët dhe shpesh raportohej që ishin shqiptarë të Kosovës  
7 por që nuk ishin nga ai komunitet. Mund ose mund të mos kenë  
8 qenë me uniforma të UÇK-së. Varej rast pas rasti.

9 ZNJ. MAYER: [Përkthim] A mund të shohim vëllimin 2 "Siç  
10 është parë, siç është treguar" që është me numër SITF0001529  
11 deri në 0001871 dhe shohim faqen SITF00001597.

12 PY. Shohim paragrafin e dytë -- më falni, paragrafin e tretë  
13 në këtë faqe kur flitet për "Ndërhyrjet individuale ...".

14 Në këtë raport ky paragraf thotë:

15 "... asnjë përpjekje zyrtare nuk është bërë nga UÇK-ja  
16 për të ndaluar praktikën e përgjithshme të ngacmimit dhe  
17 frikësimit apo për ta dënuar hakmarrjen në të gjitha ...  
18 format e veta".

19 Edhe keni dhënë një shembull kur:

20 "OSBE-ja ka pyetur komandantin e zonës së UÇK-së ... për  
21 incidentet ...".

22 Dhe këtu ka renditur dhe përgjigjet që ka marrë kur ka  
23 parashtruar këto problematika me këtë komandant zone. Ju mund  
24 ta lexoni vet në fakt. Thotë:

25 "Si prisni që të bëj unë ndonjë gjë kur unë kam personat

1 pa çati mbi kokë.

2 "Ne s'kemi kompetenca policie ...".

3 Që e përmendët dhe dje.

4 " ... KFOR-i duhet të merret me këtë punë".

5 Po unë do t'ju pyes veçanërisht për pikën 3:

6 "Nuk bëj deklaratë publike kundër masave hakmarrëse në  
7 qoftë se nuk ma kërkon Agim Çeku".

8 Z. KEHOE: [Përkthim] A mund të na e thotë për kë  
9 komandant zone bëhet fjalë këtu?

10 ZNJ. MAYER: [Përkthim] E keni poshtëshënimin në raport,  
11 kështu është shkruar raporti. I kërkoj leje Trupit Gjykses të  
12 ma lejojë pyetjen. Unë s'e kam mbaruar pyetjen, unë s'kam  
13 mbaruar, si kam vënë pikëpyetjen fjalisë, kështu që kolegu nuk  
14 e di se cila do të jetë pyetja e radhës.

15 Ju lutem më lejoni ta përfundoj pyetjen. Dhe në qoftë se  
16 unë nuk i kam thënë gjërat siç duhet jam e bindur që kolegu do  
17 tema kujtoj.

18 Z. KEHOE: [Përkthim] Po, po citoni një sërë pyetjesh nga  
19 një komandant zone UÇK-së në Dukagjin dhe pyetja jonë është me  
20 kë qenka, me kë paska ndodhur kjo bisedë?

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, duhet të  
22 specifikohet me kë ka qenë biseda.

23 ZNJ. MAYER: [Përkthim]

24 PY. E shoh që:

25 "... OSBE-ja ka pyetur komandantin e zonës së

1 Dukagjinit..."

2 Edhe ka dhe poshtëshënimin 14 që e specifikon dhe për  
3 këtë.

4 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Ju lutem të shkojmë në fund të  
5 faqes?

6 A mund të na thoni cili është burimi?

7 PË. Nuk e di për cilin individ bëhet fjalë konkretisht. Do ta  
8 kishim dhënë emrin, do e kemi pasur emrin tek procesverbali i  
9 takimit të 1 shtatorit që është marrë për bazë kur është bërë  
10 ky raport. Kështu që do të duhet të shohim edhe njëherë  
11 procesverbalin e atij takimi.

12 PY. Dje në dëshminë tuaj ju thatë se MVK-ja e OSBE-së kishte  
13 oficerë ndërlidhës që komunikonin me komandantët e zonës. Kur  
14 u kthyet në qershor deri në tetor të 1999, ju i mbajtët  
15 lidhjet me udhëheqjen e UÇK-së?

16 PË. Po, por jo në të njëjtën strukturë që kishim në MVK.  
17 OMiK-u nuk kishte një operacion quasi-militar, kështu që nuk  
18 kishim ne oficerë ndërlidhës enkas për autoritetet në atë  
19 periudhë kohore. Zakonisht ishin oficerë të të drejtave të  
20 njeriut ata që flisnin me personat që ishin përgjegjës në  
21 zonën e caktuar. Mbaheshin procesverbale të mbledhjeve me  
22 përfaqësues të KFOR-it, të OKB-së dhe kështu me radhë

23 PY. Okei. E kuptoj që nuk e dini emrin e komandantit të  
24 zonës, ju lutem që të fokusohemi tek pika numër 3.

25 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Të fokusohemi dhe një herë te pika

1 numër 3.

2 PY. Pra, tha:

3 "Nuk jap deklarata publike lidhur me masat për hakmarrjen  
4 në qoftë se nuk më udhëzon Agim Çeku".

5 Së pari, pranohet këtu që ka pasur hakmarrje dhe  
6 autoriteti këtu ka qenë Agim Çeku. Ju e përmendët dje. Kush  
7 është ai?

8 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Më falni, ku pranohet? Ku  
9 pranohet këtu që ka pasur hakmarrje. Thuhet në anglisht "nëse  
10 ka pasur ndonjë masë hakmarrje apo ndonjë veprim hakmarrjeje".  
11 Ndonjë veprim hakmarrjeje. Kjo nuk konfirmon që ka pasur  
12 hakmarrje.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,  
14 citoni pyetjen siç është këtu. Mos shtoni ju gjëra që janë të  
15 panevojshme. Nuk ka pranim këtu që ka pasur hakmarrje nga  
16 formulimi. Ai thotë nuk jap deklarata për këtë.

17 ZNJ. MAYER: [Përkthim] E kuptoj.

18 PY. Kush është Agim Çeku? E përmendët edhe dje.

19 PË. Agim Çeku ka qenë komandanti i UÇK-së.

20 PY. Gjatë kësaj periudhe kohore kur jeni kthyer ju në Kosovë  
21 pra, qershor, tetor 1999?

22 PË. Po.

23 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Vazhdojmë me një faqe tjetër nga i  
24 njëjti dokument që është në ekran që është me numër  
25 SITF0001606. Shohim në krye të faqes, paragrafi i dytë më

1 saktë. Ju lutem ta zmadhojmë pak. Faleminderit.

2 PY. Thuhet:

3 "Cenimi i të drejtës për jetën dhe cenimi i integritetit  
4 fizik ...".

5 A mund të na e shpjegoni çfarë nënkuptojnë këto terma në  
6 këtë raport?

7 PË. Këto shprehje të cilat përdoren në zhargonin e të  
8 drejtave të njeriut. Për shembull, e drejta për jetën ka të  
9 bëjë me të drejtën për të mos u vrarë apo për t'u mos u  
10 kërcënuar në një masë që mund të mendosh që vdekja është e  
11 menjëhershme.

12 Ose ndoshta shkelja e integritetit fizik ka të bëjë me  
13 sulme mbi qenien tuaj që mund të jenë, për shembull, dhunim në  
14 mënyrë të drejtpërdrejtë ose mund të jetë edhe dhunim i  
15 tërthortë, pra, edhe njëherë këto janë fjalë që përdoren në  
16 zhargonin e përgjithshëm të të drejtave të njeriut.

17 PY. E kuptoj. Në këtë paragraf vazhdohet më tej dhe thuhet ky  
18 efekt mbi gatishmërinë e njerëzve për të dhënë deklaratë dhe  
19 për zhvillime, domethënë, ulet efekti i njerëzve dhe  
20 gatishmëria e tyre për të dhënë informacion për raste të  
21 tilla.

22 Dhe pastaj nga mesi i paragrafit, thuhet më tej që ka  
23 raste të deklaratave të cilat tërhiqen ose kur individët nuk  
24 ndihen të mbrojtur në qoftë se do të japin informacion mbi  
25 kryesit. A keni vënë re një gjë të tillë në një zonë të



1 caktuar apo bëhet fjalë për një fenomen të përgjithshëm që e  
2 keni vënë re në të gjithë Kosovën në këtë periudhë në qershor  
3 të 1999?

4 PË. Raportet kanë lloje të ngjashme deklaratash, domethënë,  
5 thuhet zakonisht që individët, civilët janë të frikësuar që të  
6 japin deklaratë kundër shqiptarëve të tjerë, bashkëpatriotëve  
7 të tyre. Dhe kemi pasur, për shembull, raste të tilla kur në  
8 zyrat në terren të OSBE-së ose janë tërhequr deklaratat e  
9 mëhershme ose njerëzit nuk janë ndjerë të gatshëm që të japin  
10 deklaratë.

11 PY. A ka pasur raste gjithashtu dhe, për shembull, në qoftë se  
12 do shkojmë te paragrafi tjetër, ka pasur raste kur njerëzit  
13 pasi janë kontaktuar nga policia e UÇK-së më pas janë zhdukur  
14 a ka ndodhur kjo?

15 PË. Po. Kjo është diçka e cila ka qenë, e kemi vënë re në të  
16 gjitha raportet në të gjithë rajonet dhe gjatë periudhës së  
17 kohës për të cilën po flasim. Fillimisht, pra, vëmendja ishte  
18 tek pakicat, tek minoritetet, por ndërkohë kur pakicat filluan  
19 që të largoheshin, ne pamë që ky ishte një fenomen që u  
20 shpërnda më tej edhe në popullsinë më të gjerë shqiptare.

21 PY. Në këtë raport ose më saktë në fjalinë që po shohim kemi  
22 fjalën "policia", domethënë, policia e UÇK-së. A mund të na e  
23 shpjegoni pak më tej se çfarë do të thotë kjo?

24 PË. Sërisht në të gjithë raportin bëhet fjalë për individë të  
25 cilët ose kishin të veshur uniformat e UÇK-së, ishin të veshur

1 me uniforma ose kur janë takuar me të tjerët e prezantonin  
2 veten si të policisë së UÇK-së. "Policia" është me germa të  
3 pjerrëta se kjo nuk ishte parashikuar në Rezolutën e Kombeve  
4 të Bashkuara, pra, që UÇK-ja të funksiononte apo të kishte një  
5 polici të sajën.

6 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Do ju kërkoja që të kalonim më tej  
7 dhe të paraqitej në ekran dokumenti me numër SITF0001657. Në  
8 fund të faqes nëse mundeni.

9 PY. Dua të përqendrohemi në fund fare tek titulli ku thuhet  
10 me fjalë të theksuara "Të zhdukurit - pas ditës-K", pra, ju  
11 këtu thoni që:

12 "Kishte fjalë që disa prej personave të cilët ishin marrë  
13 ishin anëtarë të forcave të sigurimit serbë ose ishin të  
14 lidhur me persona të tillë", "ndërkohë që të tjerët nuk ishin  
15 në një lidhje të dukshme me forcat e sigurimit apo me  
16 autoritet qeveritare".

17 Ndërkohë që në paragrafin tjetër ju përshkruani një  
18 individ, një person nga komuniteti rom që "pretendohej që të  
19 ishte pjesë e një familjeje që kishte bashkëpunuar me  
20 autoritetet e mëhershme".

21 Thjesht dua t'ju pyes, a është ky një shembull i asaj  
22 çfarë përshkruat në terma të përgjithshëm sa i takon  
23 përkufizimit të termit bashkëpunëtor që përfshinte ose persona  
24 të cilët nuk është se kishin lidhje të dukshme me autoritet  
25 apo që kishin qenë pjesë e një familjeje që kishte

1 bashkëpunuar më herët me autoritet, por vetë nuk kishin bërë  
2 asgjë?

3 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] është një pyetje goxha e  
4 komplikuar dhe mund ta shikojmë në fakt edhe në transkript që  
5 Prokurorja ka lexuar për shumë kohë.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet.

7 ZNJ. MAYER: [Përkthim] T'i marrim njëra pas tjetrës.

8 PY. Së pari, flasim për individët që janë marrë që ishin ose  
9 pjesë e forcave të sigurimit ose që lidheshin me persona të  
10 tillë, a është ky një shembull i bashkëpunëtorëve që ju  
11 përshkruat gjatë dëshmisë së dhënë përpara Trupit Gjykues?  
12 PË. Po.

13 PY. Sa i takon ilustrimit ose shembullit të dytë që ka të  
14 bëjë me datën 12 qershor, ku thuhet në raport që një rom është  
15 marrë nga shtëpia e tij dhe që ai pretendoi që të ishte pjesë  
16 e një familjeje që kishte bashkëpunuar me autoritetet e  
17 mëhershme. A është edhe ky një shembull i bashkëpunëtorit që  
18 ju keni parë në terren?

19 PË. Po, megjithatë dua që të korrigjoj atë çfarë thamë më  
20 parë. Nëse dikush ishte anëtarë i sigurimit serb, për  
21 shembull, në qoftë se ishte oficer policie ose ishte në  
22 ushtrinë serbe ose kishte qenë luftëtar në radhët e tyre, në  
23 rastin e tyre nuk është se aplikohet termi bashkëpunëtor, por  
24 në qoftë se bëhej fjalë, domethënë, anëtarët e familjes ose  
25 persona të tjerë që ishin pranë tyre, atëherë përdorej termi

1 "bashkëpunëtorë" për ta.

2 PY. Faleminderit për sqarimin. Tani, në takimet që ju keni  
3 organizuar me UÇK-në a është pranuar ndonjëherë nga UÇK-ja që  
4 ata kanë marrë civilë serbë, kanë ndaluar forca ose civile  
5 serbe, domethënë, jo persona që i përkisnin ushtrisë  
6 jugosllave, por thjesht civilë të thjeshtë?

7 PË. Nuk më kujtohet. Në fakt kemi bërë kaq shumë raporte sa  
8 do më duhet që të shoh, të lexoj. Për momentin nuk më kujtohet  
9 gjë. Nuk mund t'ju them dot gjë në përgjigje të pyetjes.

10 PY. Në rregull. Në qoftë se do të gjej një pjesë konkrete të  
11 raportit që e trajton këtë gjë do t'ju tregoj.

12 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Vazhdojmë më tej me dokumentin  
13 SITF00001697. Ju kërkoj ndjesë. E thashë gabim, sepse e kalova  
14 një dokument që doja që të shfaqej në ekran.

15 Do i kërkoja Sekretares që të paraqesë dokumentin  
16 00001674, tek pjesa që fillon më "18 qershor"

17 PY. Do ju kërkoja që të shikonit pikën e fundit në këtë faqe.  
18 Atëherë, së pari, dua t'ju pyes a ju kujtohet kjo pjesë e  
19 raportit dhe për këtë arsye do i kërkoja Sekretares të kalonim  
20 tek faqja përpara e të njëjtit raport. Bëhet fjalë konkretisht  
21 për faqen SITF00001673 në fillim të faqes. Dhe në krye të  
22 faqes titulli është Shtojca 1, kronologjia e ngjarjeve. Na  
23 thatë dje që kishte shumë shtojca raporti, kjo është shtojca e  
24 parë.

25 Pyetja e parë është kjo, a ju kujtohet kjo që është

1 shtojca e parë e raportit?

2 PË. Po.

3 PY. Në rregull.

4 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Atëherë le të kalojmë tek faqja  
5 tjetër që është SITF00001674. Tek pika e fundit në këtë faqe.

6 PY. Këtu thuhet që ushtarët e KFOR-it kanë hyrë në stacionin  
7 e policisë të Prizrenit, thuhet më tej që:

8 "I kanë marrë armët UÇK-së dhe kanë marrë kontroll mbi  
9 godinën".

10 A ju kujtohet ose a mund të na thoni se ç'a do të thotë  
11 kjo që "i kanë marrë armët UÇK-së"?

12 PË. Po. Kur KFOR-i erdhi në Kosovë, UÇK-ja deri në atë moment  
13 bënte detyrat e policëve. Dhe, pra, më pas u morën armët nga  
14 UÇK-ja me kërkesë të KFOR-it dhe KFOR-i fillojë që të kishte  
15 kontroll mbi objektet dhe mbi zonat më gjerë dhe filloi që t'i  
16 përdorte këto godina ose objekte për qëllimet e synuara

17 PY. Kur thuhet që "i morën armët", domethënë, që ia morën  
18 armët UÇK-së, apo jo?

19 PË. Po.

20 PY. Këtu thuhet gjithashtu që KFOR-i gjeti dhe liroi 15 të  
21 ndaluar, njëri prej tyre ishte i vdekur. Thuhet më tej që:

22 "UÇK-ja pretendoi që personi i vdekur vdiq për shkak të  
23 një sulmi në zemër".

24 A ju kujtohet në qoftë se keni marrë informacion nga një  
25 hetues se ky ishte shkaku i vdekjes?

1 PË. A mund të kalojmë tek faqja tjetër që të mund të lexoj  
2 pak më tepër?

3 PY. Po, do kalojmë tek faqen tjetër, në fillim të faqes  
4 tjetër.

5 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Me numër SITF00001675

6 PY. Dhe është vazhdimi i fjalisë në qoftë se doni ta lexoni.

7 PË. Në qoftë se nuk ka një poshtëshënim, me shumë gjasa nuk e  
8 kemi hapur çështjen për rishikim dhe analizë ose hetim të  
9 mëtejshëm. Për shembull, kjo mund të ishte marrë nga një  
10 takim, është informacion që mund të ishte marrë nga OSBE-ja në  
11 një takim që mund të ketë pasur me KFOR-in. Dhe KFOR-i mbase  
12 mund ta ketë pas raportuar këtë si çështje. Ne mund të kemi  
13 folur me KFOR-informacioni pak më tepër lidhur me rastin. Por  
14 fakti që nuk kemi një numër lënde dhe fakti që nuk kemi një  
15 poshtëshënim, nuk mendoj se e kemi shqyrtuar më tej këtë  
16 çështje.

17 PY. Në rregull. Le të vazhdojmë në të njëjtin paragraf, në  
18 paragraf thuhet se tre nga burrat e liruar pretendojnë që janë  
19 arrestuar nga UÇK-ja dhe janë dërguar në stacionin e policisë  
20 dhe janë rrahur rëndë për 48 orë.

21 Pyetja për ju është kjo, kjo është diçka për të cilën ju  
22 do keni bërë hetime apo do ju bëjë një raport nga KFOR-i  
23 lidhur me këtë lloj incidenti?

24 PË. Nuk mendoj kështu se kanë qenë javët e para që kemi  
25 mbërritur, kështu që nuk mendoj që kemi pasur kapacitetet për

1 të ndjekur dhe për të hetuar më tej për ngjarje të kësaj  
2 natyre. Është organizuar kryesisht me biseda me KFOR-in.

3 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Le të vazhdojmë më tej me  
4 dokumentin SITF00001698.

5 PY. Nëse do shohim fillimin e kësaj faqeje, që është pika e  
6 fundit e theksuar dhe që vijon nga ajo çfarë është thënë në  
7 faqen e mëparshme, përsëri, pra, ka të bëjë me zhvillimet më  
8 datë 21 korrik. Këtu thuhet që OSBE-ja vizitoi komandantin e  
9 UÇK-së në Rahovec. A ju kujtohet kush ka qenë komandanti i  
10 UÇK-së në Rahovec ë atë kohë?

11 PË. Jo, nuk më kujtohet.

12 PY. Thuhet më tej që ka pasur diskutime që kishin të bënin me  
13 personat e zhdukur.

14 "Komandanti tha që UÇK-ja nuk ishte e përfshirë dhe çdo  
15 kush mund të blinte uniformat e UÇK-së dhe mund të pretendonte  
16 se ishte pjesëtar i UÇK-së".

17 Edhe ky është një shembull konkret, a është në pajtim apo  
18 në përputhje kjo me shpjegimet që keni marrë nga UÇK-ja kur  
19 ekipet tuaja kanë shkuar për t'u takuar me UÇK-në dhe kur keni  
20 diskutuar për pretendime të personave të zhdukur ose raporte  
21 për personat e rrëmbyer?

22 PË. Po.

23 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Vijojejmë më poshtë me raportin.

24 Kërkoj nga Sekretarja që të paraqesë në ekran dokumentin  
25 SITF00001701.

1 PY. Të shohim gjysmën e parë të faqes, pikën e katërt aty. Në  
2 qoftë se do shikojmë këtë paragrafin e madh këtu, këtu thuhet  
3 që përfaqësuesi i OSBE-së në Rahovec u takua me komandantin,  
4 ju thatë që dhe u ngritë çështja e serbëve të kidnapuar  
5 përsëri.

6 Këtu thuhet konkretisht që komandanti u pyet në qoftë se  
7 ishte dhënë një urdhër për të kidnapuar serbët e Kosovës ose  
8 në qoftë se kishte elementë të pabindur ose të padisiplinuar  
9 në radhët e tyre, pasi personat sulmues ose personat që kishin  
10 marrë, pra, serbët, kishin veshur uniforma të UÇK-së.

11 Komandanti u pyet në qoftë se kishte informacion sa i takon  
12 vendit të burrave dhe të trupave të tyre dhe komandanti tha që  
13 nuk kishte njohuri dhe nuk kishte informacion të kësaj natyre.

14 Ju thatë dje që nuk keni marrë shumë informacion, por në  
15 qoftë se do ë kishit marrë informacion, këtë informacion a do  
16 ta kishit hedhur, do ta kishit pasqyruar në raportet tuaja?

17 PË. Po.

18 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Të vazhdojmë më tej me dokumentin  
19 SITF00001706.

20 PY. Drejt fillimit të faqes pika e dytë aty.

21 Z. KEHOE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do kërkoja pak  
22 një sqarim lidhur me datën. Në qoftë se do kërkojmë që të  
23 paraqitet një faqe përpara këtij dokumenti që kemi, përpara  
24 faqes në dokumentin aktual mbase mund të shikojmë datën.

25 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Në faqen e mëparshme në fund të



1 asaj faqeje, pra, e kam fjalën për faqen SITF00001705. Titulli  
2 është "29 korrik".

3 Z. KEHOE: [Përkthim] Faleminderit.

4 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Sapo u tregua në ekran.

5 PY. A mund ta shikoni këtë, Dëshmitare? E shihni këtë faqe?

6 PË. Po.

7 PY. Kjo pika e dytë e këtij dokumenti përmend një ekip ose  
8 ekipin tuaj të të drejtave të njeriut të OSBE-së në Gjilan që  
9 është takuar me komandantin e zonës së UÇK-së. A e dini kush  
10 ishte komandant i UÇK-së në zonë atëherë?

11 PË. Jo, nuk e di.

12 PY. Këtu përshkruhet biseda që keni pasur me të dhe përmendet  
13 arrestimi i përfaqësuesve të LDK-së. Dhe përgjigja është dhe  
14 është në citim që:

15 "... 'LDK-ja nuk ka kontribuar për çlirimin e popullsisë  
16 shqiptare gjatë konflikti, ishte një parti politike e vjetruar  
17 dhe nuk ka një vend për të ardhmen e Kosovës'".

18 Kam disa gjëra të cilat kam për t'ju pyetur lidhur me  
19 këtë pjesë. Përderisa ky është citim, pra, është në thonjëza a  
20 do të thotë që ju e keni marrë fjalë për fjalë atë çfarë ju ka  
21 thënë komandanti i zonës së UÇK-së në bisedën e pasur me të?

22 PË. Po.

23 PY. Më herët sot në dëshminë tuaj keni dhënë dallimin  
24 ndërmjet LDK-së dhe UÇK-së. A e keni dëgjuar këtë pikëpamje të  
25 shprehur në takime të tjera me UÇK-në, pra, sa i takon

1 përshtypjes ose këndvështrimit të UÇK-së mbi LDK-në dhe  
2 kontributet e tyre për çlirimin e Kosovës ose mungesës së  
3 kontributit?

4 Z. KEHOE: [Përkthim] Dëshiroj që të sqarohet, domethënë,  
5 me kë i ka pasë këtë biseda, jo në përgjithësi me UÇK-në. A ka  
6 një emër, Prokurorja?

7 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Nuk e di në qoftë se ka një emër  
8 apo jo. Në qoftë se e di emrin ose ka një emër sigurisht që do  
9 ta pyes, po unë po e pyes në përgjithësi.

10 Z. KEHOE: [Përkthim] Pyetja nuk është strukturuar në këtë  
11 mënyrë. Po në qoftë se ju pretendoni që do të vazhdoni në këtë  
12 linjë mund të vazhdoni.

13 ZNJ. MAYER: [Përkthim]

14 PY. Mund t'i përgjigjeni pyetjes, Dëshmitare.

15 PË. Nuk më kujtohet emri i ndonjë individi konkret.

16 PY. E kuptoj që nuk ju kujtohet emri i ndonjë individi  
17 konkret, po a ju kujtohet në qoftë se kjo pikëpamje është  
18 ndarë me ju apo jo?

19 PË. Po.

20 PY. Sa për sqarim, për ta pasur të qartë procesverbalin. Pra,  
21 ju kujtohet që kjo pikëpamje të jetë ndarë me ju apo jo?

22 Z. KEHOE: [Përkthim] Kundërshtoj këtë qasje. Sepse të  
23 thuash një gjë e tillë pa e identifikuar dhe pa thënë se kush  
24 e ka thënë një gjë të tillë, kjo nuk është e pranueshme,  
25 domethënë, nuk mund të t'ia atribuosh këtë të gjithëve, të

1 gjithë UÇK-së?

2 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Nuk ka të bëjë fare me  
3 pranueshmërinë. Dëshmitarja thotë që i kujtohet që e ka pasur  
4 këtë bisedë me UÇK-në po nuk i kujtohet konkretisht me kë e ka  
5 pasë nga UÇK-ja një bisedë të tillë.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kundërshtimi  
7 rrëzohet. Është identifikim i mjaftueshëm për atë kohë sa në  
8 raport thuhet që këtë e ka thënë komandanti i zonës së  
9 Gjilanit.

10 ZNJ. MAYER: [Përkthim]  
11 PY. Mund t'i përgjigjeni, Dëshmitare.

12 Z. KEHOE: [Përkthim] Më falni, i nderuar Gjykatës. Sa i  
13 takon vendimit të mëparshëm tuajin, pyetja ishte:

14 "A keni pasur ndonjë bisedë me anëtarë të tjerë të UÇK-  
15 së?"

16 Jo për zonën e Gjilanit, jo komandanti i zonës së  
17 Gjilanit, s'kishte të bënte me këtë.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Është pjesë e  
19 raportit dhe këto janë informacione të akumuluar të mbledhura  
20 nga OSBE-ja dhe ajo po dëshmon lidhur me këtë.

21 Z. KEHOE: [Përkthim] E kuptoj, i nderuar Gjykatës.  
22 Megjithatë është e drejta ime për të bërë kundërshtim.

23 E kuptoj që ka kaluar shumë kohë dhe dëshmitarja nuk ka  
24 kujtesë të mirë për të gjithë gjërat e ndodhura, por ne tani  
25 jemi në një situatë të tillë kur Prokurorja po pyet disa

1 pyetje, po bën një seri pyetjesh duke u munduar që të thotë që  
2 UÇK-ja kishte ca ide për LDK-në, për të mos e përfshirë atë në  
3 qeverisje dhe duke bërë ca komente negative lidhur me qasjen e  
4 UÇK-së ndaj LDK-së.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Shumë  
6 shpjegime dhatë, e kuptoj.

7 Z. KEHOE: [Përkthim] Në rregull.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kundërshtimi  
9 rrëzohet mund të vazhdoni.

10 ZNJ. MAYER: [Përkthim]

11 PY. Përgjigjuni ju lutem.

12 PË. Në të gjitha raportet ose dokumentacionet në takimet e  
13 organizuara nga oficerët e të drejtave të njeriut dhe  
14 personave të tjerë në OSBE ishte zakon që të thuhej nga  
15 përfaqësuesit e UÇK-së dhe këto përfaqësues, për shembull,  
16 mund të ishin kryetarë komunash ose persona të zgjedhur në  
17 komunitetet vendore ose persona në uniformë, të veshur me  
18 uniformë që të thonin që LDK-ja nuk kishte bërë mjaftueshëm  
19 për të ndihmuar për çlirimin e Kosovës.

20 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ju kërkoj  
21 ndjesë, po transkripti ka ndaluar në ekranin tim. Nuk e di në  
22 qoftë se keni të gjithë të njëjtin problem, por thjesht doja  
23 t'ju sillja në vëmendje. Nuk punon transkripti.

24 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, transkripti  
25 nuk punon për momentin. Kam përshtypjen që kolegja po kërkon

1 që të bëhet një pushim derisa të fillojë të punojë përsëri  
2 transkripti ose për t'jua sjellë juve në vëmendje të paktën.

3 Z. KEHOE: [Përkthim] Nuk e di në qoftë se mund ta fikë  
4 dhe ta ndezë edhe një herë kompjuterin se jo vetëm që nuk  
5 punon transkripti, po më duket sikur nuk ka edhe dritë  
6 mjaftueshëm.

7 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Gjykatës  
8 këshillohen]

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po testoni.

10 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Në qoftë se mund të vazhdoj më tej  
11 me dokumentin SITF00001718, znj. Sekretare. Dhe le të shohim  
12 fundin e kësaj faqeje.

13 PY. Nga faqja e mëhershme, SITF00001717, në mes të kësaj  
14 faqeje është një titull që shkruan "10 gusht". Për sqarim dua  
15 të them që kjo faqe ka të bëjë me 10 gushtin se është vazhdim  
16 i faqes që përmenda më herët.

17 Në pikën e dytë thuhet që:

18 "... KFOR-i i Gjakovës ka raportuar ambientin e ndalimit  
19 të UÇK-së dhe janë arrestuar 12 pjesëtarë të UÇK-së të cilëve  
20 u janë marrë edhe armët e tyre".

21 Edhe një herë, kjo duket se është raport edhe është  
22 raportuar që ka pika të ndalimit të UÇK-së në gusht të 1999. A  
23 është kjo në përputhje me informacionin që ju keni marrë gjatë  
24 kohës që keni qenë në terren?

25 PË. Po.

1 PY. Përsëri pyetja ime është që ka pasur apo jo ambiente  
2 ndalimi të UÇK-së në atë periudhë kohore?

3 PË. Po, është e saktë.

4 PY. Në rregull.

5 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Kalojmë te dokumenti SITF00001726.

6 PY. Drejt fundit të faqes, pra është informacion që është nën  
7 "21 gushtin" dhe është tek pika që fillon "Në 16.00 ...". Ku  
8 thotë që një mashkull shqiptarë katolik është zhdukur nga  
9 Klina. Dhe thuhet që:

10 "Dy javë përpara zhdukjes së tij u raportua që "policia"  
11 UÇK-së e kishte thirrur atë për 'një bisedë informuese'". Dhe  
12 ai nuk është parë më kurrë.

13 Pyetja që kam për ju është kjo, policia e UÇK-së,  
14 domethënë, policia është në thonjëza në të gjithë raportin për  
15 shkak të faktit që UÇK-ja nuk kishte kompetencë policimi apo  
16 jo, nuk është se ishte e paqartë që dikush ka parë policinë e  
17 UÇK-së, apo jo. A mund të na e sqaroni pak këtë ju lutem,  
18 Dëshmitare?

19 PË. Me sa më kujtohet mua, në përdorimin në "policia" arsyeja  
20 për përdorimin e thonjzave është ose personat janë  
21 identifikuar që i përkasin policisë, ose mënyra sesi kanë sesi  
22 sjellë ishte e tillë që mënyra e formulimit ose e drejtimit të  
23 personave, mënyra sesi u janë drejtuar personat ishte e  
24 ngjashme me mënyrën sesi të drejtohet policia.

25 PY. Sa i takon "bisedave informuese" ju e diskutuat dhe dje

1 këtë dhe kjo ishte një praktikë e zakonshme që ka vazhduar dhe  
2 në gusht të 1999, apo jo?

3 PË. Po.

4 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Do kërkoja që të paraqitet në  
5 ekran dokumenti SPOE00198098 deri në SPOE00198366, që është  
6 raporti "Siç është parë, ashtu është treguar" volumi 1. Të  
7 shkojmë në faqen SPOE0019304.

8 PY. Nëse do të fillojmë me titullin "Rrëmbime nga UÇK-ja",  
9 nga fillimi i faqes. Tek kjo pjesë e raportit kuadri kohor  
10 është ndryshe sepse kemi të bëjmë me volumin 1 të raportit dhe  
11 këtu në paragrafin e dytë që keni në ekran mund të ta lexoni.

12 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares që ta  
13 zvogëlonte faqen për të parë dhe pjesën tjetër të faqes.

14 PY. Dëshmitare, na e thuaj në qoftë se nuk mund ta lexoni  
15 përderisa u zvogëlua faqja në ekran. Megjithatë, këtu thuhet  
16 që bëhet fjalë për periudhën e kohës në fillim të dhjetorit,  
17 pastaj nga mesi i faqes thuhet që ambasadori Walker, ka  
18 diskutuar në dhjetor të 1998 dhe në mars të 1999 sa i takon  
19 personave të zhdukur. Pra, kuadri kohor këtu është i ndryshëm  
20 sa i takon pjesës së këtyre lloj incidenteve, apo jo?

21 PË. [Nuk ka përkthim]

22 PY. Megjithatë ka raporte që ka pasur rrëmbime nga UÇK-ja,  
23 domethënë, këto raporte kanë qenë për këtë periudhë kohe, apo  
24 jo?

25 PË. Po.

1 PY. Në paragrafin në vijim thuhet se qendra e koordinimit  
2 midis OSBE-së dhe MVK-së në Prizren është marrë gjerësisht me  
3 çështjen e rrëmbimeve nga anëtarë të UÇK-së. Dhe dy paragrafë  
4 më poshtë përmenden 157 civilë serbë që ishin zhdukur nga  
5 shkurti i kaluar. Kur thuhet shkurti i kaluar, a bëhet fjalë  
6 për shkurtin 1998?

7 PË. Po.

8 PY. Sa i përket raporteve që merrni a ishte kjo diçka ku  
9 ishit përfshirë të gjithë ju gjatë kësaj kohe. Kur them gjatë  
10 kësaj kohe e kam fjalën prej momentit kur të gjithë ju  
11 punonjësit u kthyet në vend, domethënë, prej nëntorit deri në  
12 mars të 1999?

13 PË. Po. Kjo konkretisht ka të bëjë me Rahovecin, ku u kryhen  
14 luftime të ashpra, dikund në 1998 para mbërritjes së misionit  
15 verifikues. Kur arritëm atje çështje e të zhdukurve, serbëve  
16 të zhdukur, romëve të zhdukur, ishte një çështje mjaft e  
17 rëndësishme për ambasadorin Walker. U bënë përpjekje të shumta  
18 shikoni që edhe Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq ishte i  
19 përfshirë për të nxjerrë një dokument në lidhje me personat e  
20 zhdukur dhe për të përcaktuar se çfarë ka ndodhur me ta.

21 PY. Paragrafin në vijim thuhet:

22 "Numri i saktë i njerëzve që mbaheshin nga UÇK-ja ishte i  
23 vështirë për t'u përcaktuar".

24 Mund ta lexoni fjalinë në vijim për ta rifreskuar  
25 kujtesën.



Dëshmitarja: Sandra Mitchell (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje nga znj. Mayer (Vazhdim)

Faqe 33

1 PË. "Në veçanti ata me këmbëngulje i mohonin pjesëtarëve të  
2 OSBE dhe MVK-së të kishin ndaluar ndonjëherë civilë serbë".

3 PY. Dhe kjo është në poshtëshënim?

4 PË. Po.

5 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] A mund ta shikojmë faqen ku  
6 është i shënuar poshtëshënimi?

7 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Nuk është problem, mund të shkojmë  
8 në atë faqe, në qoftë se kjo do ta ndihmojë Mbrojtjen.

9 Shkojmë tek faqja SPOE00198311 ku janë shënimet  
10 përfundimtare në lidhje me këtë kapitull, mbi këtë pjesë.  
11 Mendoj se është poshtëshënimi numër 12.

12 PY. Dëshmitare, a e shikoni citimin këtu për atë që u tha se  
13 UÇK-ja mohonte të kishte ndaluar serbë të Kosovës civilë dhe  
14 citohet një takim me Adem Demaçin, përfaqësuesin politik të  
15 UÇK-së të mbajtur në dhjetor 1998?

16 PË. Po, e shoh.

17 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Në këtë dokument të njëjtë të  
18 kalojmë tek faqja SPOE00198220.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni  
20 çaktivizuar]

21 Z. KEHOE: [Përkthim] A mund ta zmadhojmë pak faqen?

22 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Shkojmë te pjesa e poshtme e  
23 faqes, te pika që fillon me arrestimet nga ana e UÇK-së. Është  
24 një shënim me titull "Ndalimet arbitrare nga anëtarë e UÇK-  
25 së". Dhe në paragrafin e fjalës thuhet si vijon:

1 "Nëpërmjet kësaj praktike UÇK-ja u përpoq që të  
2 justifikonte atë se çfarë përbënte rrëmbim të civilëve ..."

3 A mund të na shpjegoni sepse kjo është përshkruar kështu  
4 në raport?

5 PË. Siç thashë UÇK-ja mbante disa territore në Kosovë. Kjo  
6 ishte përpara intervenimit të NATO-s, domethënë, ku territori  
7 ishte nën kontrollin e serbëve kishte pjesë, xhepa që ishin  
8 nën kontroll të UÇK-së.

9 Dhe në zonat që kontrollojnë, ata mundoheshin që të  
10 ofrojnë edhe shërbime të qeverisë, shërbime që zakonisht i  
11 ofron qeveria. Dhe këtu është, për shembull, përfshihet  
12 sistemi gjyqësor, kompetencat policore dhe kështu me radhë.  
13 "Ata" këtu do të thotë përfaqësuesit e UÇK-së me të cilët kemi  
14 folur në vende të ndryshme të Kosovës.

15 Z. KEHOE: [Përkthim] A mund të identifikohen këta  
16 individë se kush ishin?

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni  
18 çaktivizuar]

19 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Në pjesën në vijim flitet për  
20 individë apo grupe të vogla njerëzish që akuzoheshin se ishin  
21 tradhtarë apo bashkëpunëtorë dhe merreshin me dhunë.

22 Thjesht më intereson shpjegimi juaj sepse raporti është  
23 shkruar në këtë mënyrë apo pse informacioni që kishit marrë u  
24 prezantua në këtë mënyrë. Është një farë vlerësimi këtu që  
25 bëhet me formulimin e përdorur që përbën "rrëmbim civilësh".

1 Z. KEHOE: [Përkthim] E kundërshtoj pyetjen e bërë.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni  
3 çaktivizuar]

4 ZNJ. MAYER: [Përkthim]

5 PY. Vazhdoni mund të përgjigjeni, Dëshmitare.

6 PË. Meqë UÇK-ja nuk kishte një autoritet të zgjedhur apo të  
7 emëruar sipas Këshillit të Sigurimit, Rezolutës së Këshillit  
8 të Sigurimit, ata, në fakt, kryenin detyra policore dhe kjo  
9 nuk ishte legjitime, e ligjshme sipas ligjit ndërkombëtar apo  
10 vendor. Dhe si rezultat i kësaj në fakt ndodhën rrëmbime dhe  
11 kidnapime.

12 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Tani të kalojmë tek faqja 1198221

13 PY. Aty nga mesi i faqes thuhet:

14 "Një shembull ilustrativ i ndalimeve nga ana e UÇK-së  
15 ndodhën në shkurt të 1999 në Reçak ...".

16 Ju përmendët Reçakun dje shkurtimisht. A ju kujtohet ky  
17 incident kur UÇK-ja rrëmbeu nëntë shqiptarë të Kosovës në  
18 Reçak?

19 PË. Po, më kujtohet shumë mirë. Ambasadori Walker ishte i  
20 pranishëm në varrim. Rrëmbimet ndodhën gjatë varrimit apo  
21 menjëherë më pas, por gjithsesi në praninë dhe në dijeninë e  
22 ambasadorit. Ai ishte i informuar se çfarë ndodhi dhe ishte  
23 jashtëzakonisht i shqetësuar me këtë sjellje që ndodhi  
24 menjëherë pas varrimeve në Reçak.

25 PY. Do të qëndrojmë dhe pak në këtë incident dhe si arsye

Dëshmitarja: Sandra Mitchell (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje nga znj. Mayer (Vazhdim)

Faqe 36

1 këtua për rrëmbimin përmenden "ka vëlla që dyshohet se punon me  
2 policinë dhe se ka armë, që pinë me oficerë policor serbë dhe  
3 kështu me radhë se janë miq".

4 Pyetja ime është kjo, këto shembuj konkretë, a përputhen  
5 me atë raportet që morët më herët në lidhje me arsyet bazë për  
6 arrestimet e pretenduara?

7 PË. Po.

8 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Kërkoj ndjesë, por kur thuhet  
9 raporte të tjera dua të jem e qartë për çfarë raportesh bëhet  
10 fjalë dhe prej kujt janë këto raporte.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofon i  
12 çaktivizuar]

13 ZNJ. MAYER: [Përkthim]

14 PY. Dëshmitare, dje, ku r folëm ju përmendët, e keni  
15 përmendur këtë në raport dhe pyetja ime është, a është ky  
16 shembull konsistent me informacione të tjera që merrnit në atë  
17 kohë?

18 PË. Po.

19 Z. KEHOE: [Përkthim] Në pyetjen e saj Prokurorja nuk  
20 lexoi një pjesë mjaft të rëndësishme ku thuhet se këta njerëz  
21 u liruan të nesërmen.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Këtë mund ta  
23 sqaroni gjatë kundërpjetjeve.

24 Z. KEHOE: [Përkthim] Në rregull.

25 DËSHMITARJA: [Përkthim] A të përgjigjem?

1 ZNJ. MAYER: [Përkthim]

2 PY. Po mund të përgjigjeni.

3 PË. Po, kjo është përputhëse dhe raporti është i përmbushur  
4 me deklaratat të ngjashme që ju janë dhënë përfaqësuesve të  
5 OSBE-së.

6 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Mund ta heqim këtë dokument. Kemi  
7 përfunduar me të.

8 PY. Dje, por edhe sot, folëm pak për çështjen e mashtruesve  
9 dhe personave që paraqiteshin sikur ishin, shtireshin se ishin  
10 anëtarë të UÇK-së. Dhe ju na dhatë vlerësimin tuaj në lidhje  
11 me këtë.

12 Pyetja ime është kjo a i bëtë pyetje përfaqësuesve të  
13 UÇK-së gjatë takimeve tuaja që kishit me komandantët e zonave,  
14 për shembull, me Ramush Haradinajn apo komandant Drinin apo  
15 komandant Remin, apo me z. Thaçi, apo me z. Çeku, në këto  
16 takime që kishit personale me ta, a kërkuat prej tyre që ta  
17 denonconin këtë apo të merrnin hapa që publikisht shpjegonin  
18 këtë sjellje si të papranueshme?

19 PË. Po.

20 PY. Çfarë përgjigje morët prej tyre?

21 PË. Varësisht nga niveli, nga hierarkia, në qoftë se kërkesa  
22 bëhej në nivel të terrenit në fshatra në qendrat rajonale,  
23 ndoshta bëheshin edhe përpjekje që të bëheshin deklaratat  
24 publike, ndoshta të lokalizuara. Mirëpo, kishte dhe raste kur  
25 kjo refuzohej sepse qëndrimi ishte se ata nuk ishin anëtarë të

1 UÇK-së, pse ne të bëjmë deklaratë publike në lidhje me këtë.

2 Në raste të tjera bëheshin deklaratata.

3 Ka bërë z. Thaçi dhe ndoshta edhe z. Çeku, varësisht nga  
4 ashpërsia e incidentit në fjalë apo e dhunës që kishte  
5 ndodhur.

6 PY. Dhe gjatë atyre rasteve, ato deklaratata a ju dhanë mediave  
7 vendore të Kosovës apo atyre ndërkombëtare?

8 PË. Të dyjave.

9 PY. A ju kujtohet të keni thënë se këto deklaratata nuk dolën  
10 në mediat vendore?

11 PË. Ndonjëherë edhe nuk dilnin sepse bëheshin në anglisht,  
12 raportoheshin vetëm në gazetatat në gjuhën angleze dhe nuk  
13 përktheheshin.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

15 Prokurore, keni kaluar kohën që keni parashikuar për t'i bërë  
16 pyetje kësaj dëshmitareje. A mund të na thoni se kur e keni  
17 ndërmend ta përfundoni marrjen në pyetje?

18 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Më kanë mbetur edhe disa  
19 dokumente. Unë kërkoj ndjesë. Do t'i kaloj shumë shpejt, kam  
20 vetëm edhe disa pyetje. Dhe besoj më kanë mbetur edhe pesë  
21 dokumente për të cilat e kam pyetur dje dëshmitaren mirëpo që  
22 nuk ia kam treguar dhe besoj që dikund deri nga pushimi i orës  
23 11.00 do të jem gati. Do të përpiqem që të përfundojë edhe më  
24 herët.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po e keni

1 kaluar kohën e parashikuar me një orë e gjysëm. Sidoqoftë  
2 vazhdoni, po sa më shpejt që të jetë e mundur përfundoni me  
3 pyetjet.

4 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Do të përpiqem. Ju faleminderit.

5 PY. Dëshmitare, t'i kthehemi dokumenteve. Në periudhën  
6 korrik, gusht 1999 që mbulohet pjesërisht nga vëllimi 2 i  
7 librit "E treguar ashtu siç është parë", a u krijua ndonjë  
8 task forcë e përbashkët në lidhje me minoritetet?

9 PË. Po.

10 PY. A mund të na thoni se kush u përfshi në këtë task forcë?  
11 Po shkurtimisht, ju lutem.

12 PË. Morëm raporte të shumta në lidhje me rrethanat e  
13 minoriteteve, pikërisht në lidhje me serbët, në atë kohë me  
14 romët, me sllavët mysliman se ata po largoheshin nga Kosova  
15 nën shoqërimin e forcave të KFOR-it dhe se kjo po ndikonte në  
16 personat që po ktheheshin. UNHCR-ja filloi që t'i shënonte  
17 këto raste dhe për të mos bërë punë të dyfishtë, ne i bashkuam  
18 si të thuash forcat dhe kjo është një prej praktikave  
19 shembullore të bashkëpunimit ndër agjencitë e ndryshme.

20 Ku faktikisht UNHCR-ja dhe OSBE-ja për punim bashkë në  
21 terren për dokumentimin dhe raportimin e situatës rreth  
22 pakicave minoriteteve. Dhe pastaj këto raporte u hartuan  
23 bashkërisht nga OSBE-ja dhe UNHCR-ja.

24 Në këtë task forcë merrnin pjesë Bill O'Nill i cili ishte  
25 këshilltari për të drejtat e njeriut i z. Kouchner, merrte

1 pjesë KFOR-i me përfaqësuesit e vet, KNKK-ja dhe agjenci tjera  
2 të OKB-së.

3 PY. Dhe ku përqendroheshit ju për sa i përket incidenteve që  
4 kishin të bëjnë me aktorët shtetërorë? Si duket nuk e kuptuat  
5 pyetjen? A kishit një pikë ku u fokusuat gjatë kësaj periudhe  
6 në punën që kryenit?

7 PË. Po. Fokusi ishte popullata e pakicave, çfarë mund të  
8 bëhej që të përmirësoheshin rrethanat, situata e tyre në  
9 mënyrë që ata të mos largoheshin nga Kosova.

10 PY. Po a u fokusuat edhe nga ana e kryeseve, domethënë, se  
11 kush po i kryente këto veprime?

12 PË. Nuk do të thoja që ishte një farë fokusi. Po thjesht  
13 mbledhje informacioni dhe raportimi i atij informacioni. Ai  
14 informacion përfshinte raporte të përgjithshme në lidhje me  
15 njerëz ose të UÇK-së të veshur si UÇK që po ushtronin presion  
16 mbi komunitetet dhe po i detyronin të largoheshin.

17 PY. A mund të na jepni një shembull në lidhje me punën e task  
18 forcës si vepronin bashkërisht këto organizata?

19 PË. Një shembull do të ishte ky, pas një raporti që morëm në  
20 Prizren në një zonë të Zhupës, mendoj që ashtu quhej, aty  
21 jetonin serbë, kryesisht njerëz të moshuar ku ishin ngacmuar,  
22 ishin keqtrajtuar dhe kështu me radhë. Dhe përfaqësuesi Bill  
23 O'Neill u takua me përfaqësuesit vendor. Ishin të pranishëm  
24 edhe KFOR-i dhe qëllimi ishte që të ndërpritej dhuna dhe më  
25 vonë kjo edhe ndodhi më vonë, domethënë, u bë një përpjekje që



Dëshmitarja: Sandra Mitchell (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje nga znj. Mayer (Vazhdim)

Faqe 41

1 të bëhej një farë intervenimi dhe ky intervenim ishte i  
2 suksesshëm.

3 PY. A ju kujtohet ndonjë moment kur u zbuluan në kompjuter  
4 dhe që një informacion ju transmetua juve?

5 PË. Po. Në Gjilan, KFOR-i kishte marrë kompjuterë nga një  
6 ndërtesë që i kishin përdorur të UÇK-së. Në kërkimin që u bënë  
7 kompjuterëve u gjet një listë emrash apo më shumë lista emrash  
8 këto lista iu dorëzuan KFOR-it, besoj që ishte Alison Jolly në  
9 atëkohë në Gjilan. Dhe ata pastaj i kërkuan që t'u ktheheshin  
10 kompjuterët dhe besoj që më në fund edhe kështu u bë.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitare,  
12 mendoj që mundeshit t'i përgjigjeshit pyetjes thjesht me "po"  
13 ose "jo". Ndigjoni me kujdes pyetjen. S'ka nevojë ndonjëherë  
14 për shpjegime të mëtejshme.

15 DËSHMITARJA: [Përkthim] Në rregull.

16 ZNJ. MAYER: [Përkthim]

17 PY. Në lidhje me përgjigjen që thatë. Ju thatë që një  
18 komandant vendor i UÇK-së kërkoi që t'i kthehej kompjuteri. A  
19 e morët këtë si pranim apo konfirmim se kompjuteri ishte i  
20 tij?

21 PË. Po.

22 PY. Dhe ju thatë që lista përmbante emra të serbëve?

23 Z. KEHOE: [Përkthim] Kundërshtim. Duhet të përcaktohet se  
24 për çfarë liste bëhet fjalë.

25 ZNJ. MAYER: [Përkthim]

Dëshmitarja: Sandra Mitchell (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje nga znj. Mayer (Vazhdim)

Faqe 42

1 PY. A mund të na tregoni se çfarë liste ishte ajo që u gjet në  
2 kompjuter?

3 PË. Ashtu si e thatë edhe ju, po nuk më kujtohet se kush na e  
4 tha këtë.

5 PY. Po qe se do t'ua tregoja deklaratën që keni dhënë më para  
6 do t'ju kujtohej kjo ngjarje?

7 PË. Po.

8 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Të vendosim në ekran dokumentin  
9 013312 deri në 01334, konkretisht na duhet faqja 013327,  
10 paragrafi 46. Versioni në shqip mban të njëjtin numër të  
11 faqes.

12 PY. Dëshmitare, lexojeni në vete paragrafin 46 dhe ma bëni me  
13 dije kur të keni përfunduar së lexuari. A kujton kjo personin  
14 që ju tregoi se kjo listë përmbante emrat të pjesëtarëve të  
15 forcave të sigurimit të Serbisë?

16 PË. Po.

17 PY. E kush jua dha këtë informacion?

18 PË. Një përfaqësues i UÇK-së.

19 PY. Dhe a bëtë ju diçka në lidhje me këtë listë?

20 PË. Po.

21 PY. Çfarë bëtë?

22 PË. Ekipi i Gjilanit u përpoq që të bënte krahasimin e këtyre  
23 emrave me emrat e personave që ishin të zhdukur.

24 PY. Dhe a ishte i suksesshëm ky hap?

25 PË. Jo.

1 PY. A mund të na thoni pse?

2 PË. Nuk kishim burimet që të ndiqnim informacionin.

3 PY. Dhe ku thuhet këtu, "këtu thuhet" a e keni fjalën për  
4 deklaratën tuaj të mëparshme?

5 PË. Po.

6 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Tani mund të shkojmë tek faqja  
7 SITF40008582, është në fakt dokument që përmban vetëm një  
8 faqe.

9 PY. Dëshmitare, do ta kaloj sa më shpjet që është e mundur  
10 këtë dokument, është një letër që mban shenjën e OSBE-së,  
11 stemën OSBE-së, misionit të OSBE-së në Kosovë. Është një  
12 memorandum që ia keni çuar ambasadorit Everts më datë 11  
13 korrik 199. A është kjo e saktë?

14 PË. Po.

15 PY. Është një memorandum i shkurtë ku flitet për objektet e  
16 ndalimit të UÇK-së. Dhe në këtë memorandum, ju thoni se jeni  
17 përpjekur të verifikoni në qoftë se ekzistojnë ose jo objekte  
18 të ndalimit. Dhe se në shkurt të 1999, ju, në fakt, ishit në  
19 gjendje që të verifikoni dhe të konfirmoni ekzistencën e  
20 tyre, apo jo?

21 Z. KEHOE: [Përkthim] Më falni. Mirëpo a mund të bëhet  
22 pyetja drejtpërdrejt pa i dhënë një hyrje dëshmitares për  
23 mënyrën si duhet të përgjigjet.

24 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Nuk ishte --

25 Z. KEHOE: [Përkthim] Nuk është ky thjesht një orientim

1 për dëshmitaren po është thjesht një deklatar.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po këtë e  
3 bëjmë të gjithë në këtë dhomë më duket.

4 Z. KEHOE: [Përkthim] përveç Mbrojtjes, Gjykatës. Ne këtë  
5 asnjëherë nuk e bëjmë.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni,  
7 znj. Prokurore.

8 ZNJ. MAYER: [Përkthim]

9 PY. Në pikën e fundit në këtë dokument përmendni shkurtin  
10 1999. A mund të na thoni se me çfarë lidhet kjo datë?

11 PË. Shkurti 1998 besoj ishte data kur KNKK-ja dhe  
12 institucionet e tjera po bënë kërkimin e të zhdukurve.

13 PY. Po ky dokument a lidhet gjithashtu edhe me objektet e  
14 ndalimit?

15 PË. Po.

16 ZNJ. MAYER: [Përkthim] shohim dokumentin me numër  
17 SPOE00127733 deri në 0127734.

18 PY. E njihni këtë dokument që ka letrën me kokë OSBE ka dhe  
19 datën në krye lart 1 shtator 1999?

20 PË. Po.

21 PY. Çfarë është ky dokument?

22 PË. Është një raport më i vogël që do bëjë pjesë e një  
23 raporti më të madh.

24 PY. A ju kujtohet kush e ka përpiluar këtë dokument?

25 PË. Jo.

1 PY. A ju kujtohet nëse e keni rishikuar dhe ju këtë dokument  
2 apo i keni dhënë dorën e fundit?

3 PË. Po, mund ta kem lexuar. Nuk më kujtohet. Po ka shumë të  
4 ngjarë që t'ia kem dhënë unë dorën e fundit këtij dokumenti.

5 PY. Dua që të orientoheni në paragrafin e tretë të faqes së  
6 parë. lexojeni pa zë dhe më pas do t'ju bëj një pyetje.

7 Në shtator të 1999 shqetësimi për cenimin e të drejtave  
8 të njeriut nga popullata shqiptare ishin të vështira që të  
9 evidentoheshin për shkak të reprezaljeve. Dhe e njëjta gjë,  
10 pra, vazhdonte situata njësoj në shtator të vitit 1999?

11 PË. Po.

12 PY. Kur thatë është "pjesë e një raporti", a mund të na thoni  
13 ku do të vendosej, ku do të përfshihej më pas ky raport?

14 PË. Me sa më kujtohet, duke parë datën, ka qenë pjesë e një  
15 raporti që do t'i jepej zyrave të OKB-së.

16 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Shohim dokumentin me numër  
17 SITF40008715 deri në 40008727.

18 PY. E njihni këtë dokument?

19 PË. Po.

20 PY. Çfarë është?

21 PË. Ky dokument duket se është një përmbledhje e situatës në  
22 Kosovë në korrik 1999. Ky është shkrimi im, pra, raport për  
23 situatën në terren.

24 PY. Edhe njëherë, ky është një dokument me shumë faqe, që nuk  
25 mund t'i shfaqim të gjitha në ekran, po a keni pasur ju

Dëshmitarja: Sandra Mitchell (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje nga znj. Mayer (Vazhdim)

Faqe 46

1 mundësi ta rishikoni këtë dokument përpara se të jepni dëshmi  
2 javën e kaluar?

3 PË. Po.

4 PY. E njihni përmbajtjen e dokumentit, ndonëse nuk është e  
5 gjitha tashmë e shfaqur në ekran?

6 PË. Po.

7 PY. A është ky një dokument që e keni përgatitur ju apo që i  
8 keni dhënë dorën e fundit apo ke dhënë miratimin për këtë  
9 dokument?

10 PË. Po.

11 PY. Siç thatë dhe ju ky është një dokument që përshkruan  
12 situatën në Kosovë në korrik të 1999?

13 PË. Po.

14 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Shohim dokument tjetër që është me  
15 numër SPOE000060118 deri në 000060123.

16 PY. Dhe ky është një dokument me shumë faqe, faqja e parë  
17 është një shënim që i drejtohet Frederick nga Sandra. Ju  
18 kujtohet kjo?

19 PË. Po.

20 PY. Ju jeni Sandra?

21 PË. Po.

22 PY. Çfarë është ky dokument?

23 PË. Fredrick punonte për selinë e OSBE-së në sektorin për  
24 parandalimin e konflikteve. Ka qenë pika jonë e kontaktit në  
25 selinë tonë. Dhe ka qenë një faks për situatën.

Dëshmitarja: Sandra Mitchell (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje nga znj. Mayer (Vazhdim)

Faqe 47

1 PY. Të shkojmë në faqen 2 të dokumentit që mban numrin  
2 SPOE000060119. Duket që në krye që kjo është një memo që ju ia  
3 keni drejtuar ambasadorit Everts. Dhe desha t'ju pyes a keni  
4 pasë mundësi ta rishikoni këtë dokument, ndonëse nuk kemi të  
5 gjitha faqet në ekran, pra, patët mundësi ta rishikoni  
6 dokumentin përpara se t'i jepnit dëshminë?

7 PË. Po.

8 PY. A mendoni se ky është një informacion që keni përgatitur  
9 ju?

10 PË. Po.

11 PY. Lidhur me situatën në Kosovë në korrik të 1999?

12 PË. Korrekt.

13 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Në rregull. Shohim dokumentin  
14 SITF40008439 deri në 40008441.

15 PY. Këtu përmendet një mbledhje e grupit kryesor të të  
16 drejtave të njeriut edhe pjesëmarrësit e renditur këtu. A mund  
17 të na thoni çfarë është ky dokument?

18 PË. Është një përmbledhje e një takimi që kanë pasur  
19 organizatat për të drejtat e njeriut.

20 PY. Këtu janë pasqyruar dhe diskutimet që keni bërë gjatë  
21 takimit të gjitha aspektet që keni trajtuar?

22 PË. Po.

23 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Vazhdojmë. Shohim dokument IT --  
24 më falni do ta rifillojmë, pra, dhe njëherë. IT-05-87 P00432.

25 PY. Dje thatë që ka pasur një marrëveshje për misionin e

1 verifikimit në Kosovë, me misionin verifikues në Kosovë. E  
2 njihni këtë dokument?

3 PË. Po.

4 PY. A është kjo marrëveshja për të cilën folët dje?

5 PË. Po, kjo është.

6 PY. Vetëm faqja e parë është në ekran, po dhe ky është një  
7 dokument me shumë faqe. A patët mundësi ta rishikoni para se  
8 të jepnit dëshminë sot?

9 PË. Po.

10 PY. A është kjo marrëveshja që përmendët dje në dëshminë  
11 tuaj?

12 PË. Kjo është.

13 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Shohim dokumentin me numër IT-05-  
14 87 P00456

15 PY. Po ashtu thatë në dëshminë dje, përmendët dje një  
16 rezolutë të këshillit të sigurisë së OKB-së. E shihni  
17 dokumentin që keni në ekran?

18 PË. Po.

19 PY. A është kjo rezoluta që përendët dje?

20 PË. Unë përmenda dy dje. Besoj që kjo është ajo që ka lidhje  
21 me MVK-në.

22 PY. Edhe në këtë rast vetëm faqja e parë është në ekran.

23 Është dokument me shumë faqe. Patët mundësi ta rishikonit para  
24 se të jepnit dëshmi?

25 PË. Po.



1 PY. Ky dokument me shumë faqe, a është rezoluta e këshillit  
2 të sigurisë që trajton MVK-në.

3 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Shohim dokumentin IT-05 87 P00766.  
4 Më falni u nxitova pak. Duhet të ndjek një rend tjetër. Shohim  
5 dokumentin IT-05-87 P00861. Besoj se ky është dokumenti.

6 PY. E njihni këtë dokument?

7 PË. Po.

8 PY. Çfarë është?

9 PË. Është një na dokumentet origjinalë ku përshkruhen detyrat  
10 e departamentit të të drejtave të njeriut, çfarë funksionesh  
11 do të kishin, çfarë metodologjie do të kishin.

12 PY. Keni qenë e përfshirë në përgatitjen e këtij dokumenti?

13 PË. Po.

14 PY. Keni qenë e përfshirë në miratimin përfundimtar të këtij  
15 dokumenti?

16 PË. Po.

17 PY. E miratuat?

18 PË. Po.

19 PY. Edhe një herë ky është vetëm faqja e parë në ekran.

20 Dokumenti ka shumë faqe. Patët mundësi ta rishikoni para se të  
21 vinit këtu?

22 PË. Po.

23 PY. A është kjo përmbledhja që keni miratuar ju sa i takon  
24 punës së drejtorisë për të drejtat e njeriut pranë MVK-së?

25 PË. Po.

1 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Shohim dokumentin me numër IT-05-  
2 87 P00863.

3 PY. A e njihni këtë dokument që mban datën 17 dhjetor 1998  
4 dhe ka titull "Misioni Verifikues në Kosovë i OSBE-së Plani  
5 Operacional i Divizionit për të Drejtat e Njeriut?

6 PË. Po.

7 PY. Vetëm faqja e parë është shfaqur në ekran. E njihni këtë  
8 dokument?

9 PË. Po.

10 PY. Patët shans ta rishikonit përpara se të vinit këtu?

11 PË. Po.

12 PY. A është ky një dokument që e keni rishikuar apo miratuar  
13 para se të lëshohej si dokument?

14 PË. Po.

15 PY. Sikurse thotë edhe titulli, a flitet këtu për punën  
16 operacionale të MVK-së gjatë periudhës, pra, për gjatë  
17 periudhës që MVK-ja ka qenë operative në Kosovë nga viti 1998  
18 deri në momentin që u larguat?

19 PË. Po.

20 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Tani të shohim dokumentin me numër  
21 IT-05-87 P00766.

22 PY. E njihni këtë dokument?

23 PË. Po.

24 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Ta ulim pak dokumentin që të  
25 shohim titullin.

1 PY. "Udhëzime mbi klasifikimet" është titulli i këtij  
2 dokumenti edhe është shënuar dhe fakti që është versioni i  
3 parë dhe më pastaj flitet për:

4 "Klasifikimin e incidenteve të të drejtave të njeriut të  
5 MVK-së ..."

6 Është një dokument ky që e keni rishikuar para se të  
7 jepni dëshmi sot?

8 PË. Po. Kjo vetëm faqja e parë është në ekran. A i keni  
9 rishikuar të gjitha faqet përpara se të jepnit dëshmi?

10 PË. Po.

11 PY. A është ky një nga dokumentet që ju e keni miratuar?

12 PË. Po.

13 PY. A e shihni shkrimin e dorës? E njihni këtë shkrim dore?

14 PË. Po.

15 PY. I kujt është?

16 PË. I imi.

17 PY. A është ky një nga dokumentet që ju e keni përdorur në  
18 kuadër të punës tuaj të drejtave të njeriut pranë MVK-së në  
19 Kosovë?

20 PË. Po.

21 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Shohim dokumentin IT-05-87 P00765.

22 PY. A njihni dokumentin në ekran?

23 PË. Po.

24 PY. A mund të na thoni çfarë është?

25 PË. Është një shabllon që e përdorte personeli i OSBE-së që

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Sandra Mitchell (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje nga znj. Mayer (Vazhdim)

Faqe 52

1 punonte në kampet e refugjatëve në Maqedoni, e shihni M aty. M  
2 nënkuptonte mbledhje të informacionit nga refugjatët.

3 PY. Në dëshminë tuaj dje ku përshkruat mënyrën si  
4 grumbullonit informacione nga refugjatët qoftë në kampet apo  
5 në familjet pritëse, ishte ky një nga instrumentet që e  
6 përdornit për këtë qëllim?

7 PË. Po.

8 PY. Vetëm faqja e parë është shfaqur në ekran. A e keni  
9 rishikuar të gjitha faqet e këtij dokumenti përpara se të  
10 jepni dëshmi?

11 PË. Po.

12 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Nëse vazhdojmë më poshtë dhe  
13 shohim faqen e katërt të këtij dokumenti.

14 PY. Ky duket si fillimi i një faqeje tjetër, ka titull tjetër  
15 "Formulari për monitorimin e refugjatëve", duket se ky  
16 dokument ka qenë i përbërë nga dy formularë. A mund të na e  
17 shpjegoni pse?

18 PË. Një nga formularët përdorej për refugjatët në kampe dhe  
19 tjetra përdorej për refugjatët me familjet pritëse.

20 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Falënderoj, Trupi Gjykses që më  
21 dha kohën e nevojshme. Përfundova me dokumentin dhe nuk kam më  
22 pyetje.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni  
24 çaktivizuar]

25 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Po. Kërkoj që të pranohen si prova

1 dokumentet në vijim.

2 Z. KEHOE: [Përkthim] Teksa presim numrat, a mund të na  
3 jepni ne një ide për çfarë dokumentesh bëhet fjalë, se ka  
4 pasur shumë dhe nuk i kemi ndjekur dot të gjitha me tërë këto  
5 numra që janë përmendur deri tani.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni  
7 çaktivizuar]

8 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Në rregull. Që të jem sa më  
9 shpejt, ta bëj sa më shpejt nuk po ndjek rendin që ia tregova  
10 dëshmitares, po ndjek rendin që kam në listën time.

11 Doni që të ndjek rendin që ndoqa me dëshmitaren?

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në qoftë se e  
13 ke do ishte më e volitshme, do ishte më e lehtë që ta ndiqnim.

14 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Në rregull atëherë. Kështu po  
15 veprojmë.

16 Janë një a dy dokumentet që kanë numrat e provës  
17 materiale sepse janë pranuar tashmë si prova dhe nuk është  
18 nevoja që të përmenden dhe njëherë. Tani dokument i parë është  
19 SITF00001529 deri në 0001871, vëllimi 2 i raportit "Siç parë,  
20 siç është treguar".

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Është pasqyra  
22 e lëndës?

23 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Jo, është i gjithë dokumenti.  
24 Është nga 1529 deri në 00001871.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A është i

1 gjithë dokumenti?

2 Keni kundërshtime?

3 Z. KEHOE: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar] Ky është  
4 vëllimi 2. Është shumë.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Synoni të  
6 kërkoni dhe pranimin e vëllimin 1?

7 Z. KEHOE: [Përkthim] Ky është një. Nuk kam kundërshtime  
8 atëherë për asnjë nga vëllimet.

9 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Po, kemi kundërshtim që të  
10 pranohet i gjithë raporti. Në vendimin që nxorët ju, i nderuar  
11 Gjykatës, për pranueshmërinë e këtij raporti, sipas rregullave  
12 154, ka pasur shumë shqetësime që janë parashtruar që mbase  
13 mund të shpjegohen më mirë pa praninë e dëshmitares. Po ne e  
14 kundërshtojmë. Dhe kemi plan të kundërshtojmë pjesën më të  
15 madhe të këtyre dokumenteve që synojnë të pranohen.

16 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Unë nuk përfundoj dot me  
17 dëshmitaren në qoftë se nuk e di, nuk e bëja dot punën time pa  
18 ia treguar të gjitha dokumentet dëshmitares përndryshe s'do  
19 përfundoja kurrë.

20 Edhe sa i takon rregullës 154, vërej që Mbrojtja nuk  
21 kundërshtoi në momentin e duhur. Edhe Gjykata nuk i pranoi  
22 paraprakisht raportet dhe tha që në qoftë se ia tregojnë  
23 dëshmitares, ne jemi të interesuar në metodologjinë në  
24 informacionin themelor dhe të gjitha këto që ju interesoheni  
25 tashmë janë trajtuar me këtë dëshmitare.

1           Z. ELLIS: [Përkthim] Dhe ne kundërshtojmë. Është 343 faqe  
2 raport. E numërova shpejt e shpejt teksa po dëgjonim. Nja 15  
3 faqe u treguan dëshmitares, mbase diçka më shumë, po ama ka  
4 qindra faqe që nuk ju treguan dëshmitares.

5           Edhe më shumë se kaq, ju keni konsideruar këtë në  
6 mocionin sipas rregullës 154. Dhe kjo është në parashtrimin e  
7 protokolluar 1380, paragrafi 87. Shqetësimet e evidentuara në  
8 parashtrimet mbeten të njëjtat.

9           Do të doja të trajtonim më në thellësi, po e kuptoj dhe e  
10 pranoj atë që tha një nga avokatët e z. Veseli që mbase për  
11 këtë diskutim dëshmitarja nuk është e nevojshme të jetë e  
12 pranishme në sallë, nuk është e nevojshme që dëshmitarja të  
13 jetë këtu.

14                           [Anëtarët e Trupit Gjykues këshillohen]

15           KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë 1 dhe  
16 2 do të shënohen për identifikim. Pra, e kisha fjalën vëllimi  
17 1 dhe vëllimi 2.

18           Z. KEHOE: [Përkthim] Unë dhe kolegët atëherë e tërheqim  
19 faktin që nuk kisha kundërshtime. Do konsultohem më vonë, po  
20 megjithatë për momentin bashkohem me kolegët e mi dhe  
21 kundërshtoj dhe unë pranimin e tyre.

22           KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull. E  
23 kuptoj.

24           Vazhdoni.

25           ZNJ. MAYER: [Përkthim] Mirë atëherë. Po ju jap ERN për

1 vëllimin e dytë. E dhashë vëllimin e dytë, po mendoja vëllimin  
2 e parë, më falni. SPOE00198098-00198366. Dhe është i ndarë në  
3 dy dokumente, pjesa e dytë e këtij dokumenti fillon me  
4 SPOE00198367. Ju kërkohet falje se s'e kisha numrin e fundit --  
5 a jo, e kam. Atëherë 367 deri në 001988834. Është një dokument  
6 i ndarë në dy ERN, po ky është vëllimi 1 në tërësinë e vetë.  
7 Vetëm gjysma e parë i është treguar dëshmitares. Besoj se edhe  
8 kjo do të shënohet për identifikim.

9 Doni të vazhdoj.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni.

11 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Dokumenti i radhës SITF40008582  
12 deri në 40008582. Që është memoja e OSBE-së e korrikut 1999  
13 lidhur me objektin e ndalimit të UÇK-së.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka  
15 kundërshtime?

16 Z. KEHOE: [Përkthim] Më jepni kohë t'ju hedh një sy  
17 dokumenteve dhe do t'ju komentoj më vonë. Më mirë t'ju jepni  
18 një numër për identifikim për momentin. Sepse janë shumë  
19 dokumente duam t'i hedhim një sy, duam t'i lexojmë.

20 ZNJ. MAYER: [Përkthim] E kuptoj dallimin tek vëllimi i  
21 raportit që ne kishim shfaqur vetëm 15 faqe. Të gjitha  
22 dokumentet tjera shumë të shkurtra që ose i kemi pasur si të  
23 përfshira në listën tonë sipas rregullit 154 muaj më përpara.  
24 Ia dhënë Mbrojtjes, janë vënë në dijeni që do t'i përdornim në  
25 këtë dëshmitare në mënyrë që të realizonim pyetjet me këtë



1 dëshmitare, përndryshe ne nuk e dinim çfarë dëshmie do të  
2 merrnim pa i paraqitur dokumentet.

3 Z. KEHOE: [Përkthim] Ju lutem.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni  
5 çaktivizuar]

6 Z. KEHOE: [Përkthim] Në qoftë se unë shoh një dokument,  
7 për shembull, formularin --

8 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Është një dokument vetëm me një  
9 faqe që e kam përdorur në orën e fundit me këtë dëshmitare.

10 Z. ROBERTS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, janë përdorur  
11 shumë dokumente gjatë orës së fundit, kështu që do ishte më  
12 mirë që të paraqitet në ekran.

13 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Do t'ia lë në dorë Gjykatësve këtë  
14 gjë.

15 Z. KEHOE: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë  
17 dokumenti me numër 8582 pranohet.

18 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Dokumenti i radhës është  
19 SPOE00127733 deri në 00127734, është një raport i OSBE-së që  
20 mban datën 1 shtator 1999. Trajtohet situata e të drejtave të  
21 njeriut në Kosovë në këtë raport.

22 Z. KEHOE: [Përkthim] Këtu është paraqitur vetëm një pjesë  
23 e vogël e raportit, jo të gjithë dokumentin. Nëse doni të  
24 pranoni atë që ju tregua dëshmitares, në rregull.

25 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Ky është një dokument që

1 dëshmitarja e identifikoi si një dokument që ajo e kishte  
2 miratuar ku përshkruhej situata në terren. Nëse qëndrimi i  
3 Gjykatës është që duhet të flasë për çdo detaje të vetëm  
4 dokument, atëherë do kemi shumë kundërshtime për dokumentet.  
5 Nuk mund të funksionojë në këtë mënyrë.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo. Dokumenti  
7 pranohet.

8 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Dokumenti i radhës është me  
9 SITF4008715 deri në 4008727. Dhe kjo është një memo për  
10 situatën në terren me datën 19 korrik 1999, dëshmitarja tha që  
11 është shkrimi i saj i dorës dhe që është një memo që ajo e ka  
12 përgatitur dhe e ka miratuar nga OSBE-ja.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kundërshtime?

14 Z. KEHOE: [Përkthim] E di që është nënshkrimi i saj, po  
15 unë nuk mbaj mend që ka thënë ajo që e përpiloj se mbase ka  
16 ndonjë gabim.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo, tha që e  
18 ka miratuar.

19 Z. KEHOE: [Përkthim] I njëjti kundërshtim. I njëjti  
20 kundërshtim vlen sikurse u tha më herët.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë kjo  
22 provë materiale pranohet.

23 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Dokumenti i radhës SPOE0060118  
24 deri në 00060123. Dhe kjo është një memo e OSBE-së me datën 24  
25 korrik 1999. Kjo është datë në faqen e parë pas ballinës. Janë

1 një sërë memosh këtu, për të cilat dëshmitarja tha se i ka  
2 përpiluar dhe i ka dërguar.

3 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Unë kam kundërshtim për këtë.

4 Z. KEHOE: [Përkthim] I njëjti kundërshtim.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A mund të  
6 afroheni më shumë te mikrofonin ju lutem. Në rregull.

7 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Është vendimi F1380, lidhur me  
8 këtë dokument:

9 "Trupi Gjykes nuk do ta pranojmë këtë dokument në këtë  
10 moment. Në qoftë se ZPS-ja gjykon që dëshmitarja mund të japë  
11 dëshmi shtesë. Sa i takon përmbajtjes së dokumentit, duhet të  
12 pyesë dëshmitaren gjatë dëshmisë *viva voce* për këtë dokument".

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Prova  
14 materiale pranohet.

15 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Dokumenti i radhës SITF40008439  
16 deri në SITF40008441. Është procesverbali i një takimi që ka  
17 pasë OSBE-ja me organizatat e të drejtave të njeriut,  
18 dëshmitarja tha se ka qenë pjesë e këtij takimi.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka  
20 kundërshtime?

21 Z. KEHOE: [Përkthim] Të njëjtat kundërshtime.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti  
23 pranohet.

24 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Dokumenti i radhës IT-05-87  
25 P00432. Është marrëveshja për misionin verifikues në Kosovë të

1 OSBE-së me datën 19 tetor 1998.

2 Z. KEHOE: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet.

4 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Dokumenti i radhës është IT-05-87  
5 P00456. Është Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të  
6 Bashkuara numër 1199 e 1998 që ka të bëjë me MVK.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka  
8 kundërshtim?

9 Z. KEHOE: [Përkthim] Jo, nuk kemi kundërshtime. Por e  
10 vetmja pyetje që ka të bëjë me rezolutën është e kam  
11 përshtypjen që e kemi pranuar diku tjetër. Pra, mendoj që  
12 Rezoluta 1199 është pranuar.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kemi  
14 përmendur shumë Rezolutën 1244, por jo këtë. Nuk e kujtoj. Nuk  
15 e di.

16 Ndoshta Sekretarja e seancës mund ta verifikojë,  
17 megjithatë për momentin do ta pranojmë dokumentin dhe do jetë  
18 pezull caktimi i numrit të provës materiale derisa të bëhet  
19 verifikimi përkatës.

20 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Dokumenti tjetër është IT-05-87  
21 P00761. Është task forca dhe këndvështrimi i përgjithshëm i të  
22 drejtave të njeriut në kuadrin e misionit të verifikimit të  
23 Kosovës që u përshkrua nga dëshmitarja gjatë dëshmisë së saj.

24 Z. KEHOE: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti

1 pranohet.

2 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Dokumenti i radhës është IT-05-87  
3 P00763. Është Plani Operativ i Departamentit të Të Drejtave të  
4 Njeriut që dëshmitarja tha që e ka nënshkruar, e ka miratuar.

5 Z. KEHOE: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet  
7 dokumenti.

8 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Dokumenti i radhës është IT-05-87  
9 P00766. Është udhëzimi lidhur me klasifikimin. Përsëri është  
10 një dokument për të cilin dëshmitarja tha që do ta kishte  
11 miratuar.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë për të  
13 shtuar, ndonjë kundërshtim?

14 Z. KEHOE: [Përkthim] Nuk ka kundërshtime.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet  
16 dokumenti.

17 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Dokumenti i radhës është IT-05-87  
18 P00765 që janë formularët për monitorimin e refugjatëve.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për  
20 procesverbal ka dy formularë apo jo?

21 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Po. Është pjesë i së njëjtit  
22 dokument.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë  
24 kundërshtim për formularët?

25 Z. KEHOE: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Sandra Mitchell (Vijon) (Seancë e hapur)  
Çështje procedurale

Faqe 62

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] atëherë

2 dokumenti pranohet me të dy formularët e vet.

3 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Këto ish-in të gjitha dokumentet,

4 po megjithatë për derisa Gjykata ka vendosur numrin e

5 përkohshëm të identifikimit për raportin "Siç është parë ashtu

6 është treguar" mendoj që do ishte mirë që të përmendja

7 fragmente të cilat ne i kaluam me dëshmitaren gjatë marrjes në

8 pyetje të Prokurorisë.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

10 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Në rregull. Për Volumin 2 që është

11 dokumenti SITF00001529 deri në 00001871, fragmentet e

12 përdorura me dëshmitaren janë si më poshtë: SITF00001571.

13 SITF00001581 deri në SITF00001582. Fragmenti tjetër është

14 SITF00001585 deri në SITF00001586. Fragmenti tjetër është

15 SITF00001596. Fragmenti tjetër është SITF00001597. Pjesa

16 tjetër është SITF00001606 dhe pjesa tjetër është SITF00001657.

17 Më tej vazhdojmë me SITF0000164 deri në SITF00001675. Pjesa

18 tjetër është SITF00001698. Pjesa tjetër --

19 Z. KEHOE: [Përkthim] Znj. Prokurore, kam përshtypjen që

20 harruat një numër për të thënë tek dokumenti i fundit.

21 ZNJ. MAYER: [Përkthim] 74 deri në 75, për këtë e kishit

22 fjalën. Është kjo që mban numrin 1608?

23 Z. KEHOE: [Përkthim] Po, në rregull.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Këtë kam dhe

25 unë. Bëhet fjalë për ndonjë tjetër numër?

1 Z. KEHOE: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar]

2 ZNJ. MAYER: [Përkthim] 1674 deri në 1575 këtë thashë.

3 Z. KEHOE: [Përkthim] E thatë. Po ajo çfarë po them unë  
4 është që ekran del 164 në vend që të dilte si 1674.

5 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Kërkoj ndjesë. Nuk i them dot edhe  
6 numrat edhe të shikoj çfarë shkruhet në transkript, ju kërkoj  
7 ndjesë.

8 Z. KEHOE: [Përkthim] Thjesht doja ta korrigjoja.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po keni të  
10 drejtë duhet që të pasqyrohet siç duhet në transkript. Duhet  
11 të jetë 1674.

12 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Në rregull. Mund të vazhdojmë më  
13 tej, 1698. Vazhdojmë më tej SITF00001787. Pastaj vazhdojmë me  
14 dokumentin tjetër është SITF00001717 deri në 1718. Sa për  
15 sqarim këto dy faqet e mëparshme, domethënë, këto faqe neve i  
16 treguam thjesht sa për të konfirmuar datën por përmbajtja  
17 ishte në faqet pasuese.

18 Në volumnin 2 dokumentet janë si më poshtë: SITF00001726.  
19 Kjo ishte për dokumentin e parë.

20 Për volumnin e parë lista është goxha më e shkurtër sesa  
21 në rastin e volumnit të dytë. Kam pyetur vetëm për dy gjëra  
22 konkrete dëshmitaren. Pjesa e parë për të cilën e kam pyetur  
23 dëshmitaren është SPOE00193, ju kërkoj ndjesë e thashë gabim  
24 198304, po më pas ne shkuam në fund të faqes të poshtëshënimi  
25 që ishte në dokumentin SPOE00198311. Ky ishte shembulli i parë.

1 I dyti ishte në faqen SPOE198202 deri në SPOE0098221.

2 Këto ishin të gjitha shembujt konkrete.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

4 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë që e zgjatëm kaq  
5 shumë.

6 Z. ELLIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, sa i takon  
7 pikës për identifikimin e përkohshëm të dokumentit gjatë  
8 pyetjeve të Mbrojtjes mund të prekim çështje të cilat kanë të  
9 bëjnë me pranueshmërinë, nuk e di se çfarë do vendosim më pas  
10 për këto dokumente, por thjesht do sugjeroja që vendimin të  
11 mund ta bënim pasi të bëhen pyetjet nga Mbrojtja.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ne mund ta  
13 marrim vendimin menjëherë.

14 Megjithatë, do bëjmë pushimin tani. Do bëjmë deri në orën  
15 12.00 besoj, apo jo. Jo, deri në 12.00 pa 20.

16 Në rregull, bëjmë pushimin tani.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju kërkoj  
18 ndjesë. Ju lutem nxirreni dëshmitaren salla. E harruam fare  
19 dëshmitaren.

20 [Dëshmitarja përfundon dëshminë]

21 --- Pauza fillon në orën 11.09

22 --- Seanca rifillon në orën 11.44

23 GJYKATËSI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të  
24 uleni se nuk jemi gati akoma.

25 Meqenëse ra fjala, dokumenti ose Rezoluta 1191 nuk duket



1 asgjekundi tjetër.

2 Z. KEHOE: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar]

3 GJYKATËSI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,  
4 sa për t'ju thënë që e kontrolloam dhe nuk është regjistruar.

5 Unë pata një bisedë me Administratoren, të gjithë neve në  
6 fakt, dhe ajo më siguroi që, së pari, sa i takon z. Selimi, z.  
7 Selimi ka kërkuar siç duhet telefonatat me familjarët e tij.  
8 Edhe që prej kohës kur është futur në fuqi urdhri i përkohshëm  
9 ai ka realizuar 11 biseda telefonike të tilla.

10 Sa i takon z. Thaçi dhe z. Veseli, nuk ka pasur  
11 absolutisht asnjë kërkesë për telefona me familjarët e tyre  
12 prej tyre, pra për këta të dy të akuzuar. Dy ekipet e  
13 Mbrojtjes thatë që keni bërë kërkesa por, ndërkohë duhet ta  
14 dini në qoftë se e keni bërë një gjë të tillë apo jo. Duhet të  
15 jenë të vërteta, sepse nuk ja vlen që të marrim informacion  
16 prej jush që nuk ka ndodhur diçka, ndërkohë që diçka e tillë  
17 ka ndodhur ose e kundërta, domethënë informacioni që duhet të  
18 shkëmbejmë duhet të jetë i saktë.

19 Është e qartë e ekipet e dy të akuzuarve që përmenda nuk  
20 e kanë kërkuar në asnjëfarë trajte apo forme thirrjet  
21 telefonike me familjarët e tyre. Në qoftë se ata dëshirojnë që  
22 ta bëjnë një gjë të tillë, mund të bëjnë kërkesat. E siç e  
23 kemi thënë bisedat do të monitorohen. Megjithatë, është paksa  
24 bezdisëse që të diskutohet një informacion i tillë, që ta  
25 hedhim një informacion të tillë në procesverbal dhe ky

1 informacion të mos jetë i vërtetë.

2 Sikurse e thashë, ju lutem, kontrolloni informacionin dhe  
3 të jeni të sigurt që informacioni që na thatë është i vërtetë.

4 Z. Veseli, Mbrojtja e z. Veseli u ngrit në këmbë dhe tha - jo,  
5 z. Emmerson, më falni, z. Emmerson për z. Veseli tha që ka  
6 bërë tre kërkesa për telefonata, për thirrje të klientit të  
7 tij. Një gjë e tillë nuk ka ndodhur.

8 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nuk jam  
9 informuar për këtë çështje. Dua që të më jepni mundësi që të  
10 pyes.

11 GJYKATËSI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk po ju  
12 kërkoj që të pyesni por, po ju kërkoj që të mbani parasysh  
13 këtë informacion.

14 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Në rregull.

15 GJYKATËSI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të gjitha i  
16 transferohen, të gjitha kërkesat i dërgohen automatikisht  
17 Administratores.

18 Z. ROBERTS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, në qoftë se  
19 mund t'ju përgjigjem shkurtimisht asaj çfarë thatë. Unë nuk e  
20 thashë këtë për procesverbal dhe ju lutem më korrigjoni në  
21 qoftë se e kam gabim, po këto janë kërkesa të cilat janë dhënë  
22 që prej të dielës.

23 Në qoftë se nuk jam keqshprehur, unë nuk kam thënë që z.  
24 Veseli - që z. Selimi ka bërë kërkesë që prej të dielës.

25 Thjeshtë unë ju mora informacion për të ditur se çfarë do të

1 ndodhë me thirrjet.

2 GJYKATËSI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,  
3 mund ta sillni dëshmitaren.

4 Z. O'Reilly, klienti e ngriti dorën. Mbase doni të flisni  
5 me të.

6 Pjesa e dytë është kjo: Nga volumi 1 dhe 2 do të pranojmë  
7 si prova materiale vetëm ato pjesë apo ato paragrafë të cilët  
8 u përmendën nga Prokurorja me faqet përkatëse. Kështu që  
9 Sekretarja do të caktojë numrat e provave materiale. Mbase do  
10 të duhet ca kohë sepse Sekretarja duhet të kalojë të gjithë  
11 numrat e provave materiale për dokumentet e cituara më herët.

12 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit, të  
13 nderuar Gjykatës.

14 Sa i takon dokumentit të parë që kërkuat të regjistrohet  
15 si provë ose do të filloj me volumet e librit në qoftë se më  
16 lejoni, të nderuar Gjykatës.

17 [Dëshmitarja vijon dëshminë]

18 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Për volumin që është  
19 dokumenti SPOE00198366 dhe pjesët të cilat u paraqitën për t'u  
20 pranuar si prova materiale do të marrin numrin e provës  
21 materiale P743.1

22 Për pjesën e dytë për volumin 1, që ka numrin e  
23 identifikimit SPOE00198367 deri në 198834, do të marrë numrin  
24 e provës materiale P743.2.

25 Dhe për sa i takon pjesëve të marra nga volumi i dytë i

1 librit, që identifikohen me numrin SITF000015929 deri në  
2 00001871, do të marrin numrin e provës materiale P743.3

3 Më pas, të nderuar Gjykatës, dokumenti i radhës  
4 SITF400008582 deri në 400008582 do të marrë numrin provës  
5 materiale P744.

6 Dokumenti SPOE00127733 deri në 00127723 do të marrë  
7 numrin e provës materiale P745.

8 SITF40008715 deri në 400087237 do të marrë numrin e  
9 provës materiale P746.

10 SPOE00060118 deri në 0006134 do të marrë numrin e provës  
11 materiale P747.

12 SITF40008439 deri në 40008441 do të marrë numrin e provës  
13 materiale P748.

14 Dokumenti IT-05-87 P00432 do të marrë numrin e provës  
15 materiale P749.

16 Dokumenti IT-05-87 P00456 do të marrë numrin e provës  
17 materiale P750.

18 Dokumenti IT-05-87 P00761 do të marrë numrin e provës  
19 materiale P751.

20 Dokumenti IT-05-87 P00763 do të marrë numrin e provës  
21 materiale P752.

22 Dokumenti IT-05-87 P00766 do të marrë numrin e provës  
23 materiale P753.

24 Dhe së fundi, dokumenti IT-05-87 P00765 do të marrë  
25 numrin e provës materiale P754.

1 Dhe së fundi, të nderuar Gjykatës, dua të them që të  
2 gjitha këto janë caktuar si konfidenciale me përjashtim të  
3 rasteve kur do të më udhëzoni që t'i klasifikoj ndryshe këto  
4 dokumenta.

5 GJYKATËSI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Prokurore,  
6 duhet që të caktohen si konfidenciale apo jo?

7 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Jo, mund të caktohen dhe si  
8 publike. Megjithatë, dua të them që nuk besoj që kemi ofruar  
9 apo përmendur një fragment apo një paragraf që është tani në  
10 prova materiale siç thathë 743.2, për sa i takon gjysmës së  
11 dytë të volumit të parë. Besoj që të vetmet fragmente, dy  
12 fragmentet apo paragrafi që kemi përdorur janë pjesa e një  
13 dokumenti në PDF që është prova 743.1

14 Nuk mendoj se ka ndonjë ndryshim sa i takon caktimit të  
15 numrit për Gjykatën, por gjithsesi sa për t'ja u bërë të  
16 ditur.

17 GJYKATËSI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]  
18 Faleminderit.

19 Ka ndonjë kundërshtim.

20 Z. KEHOE: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar]

21 GJYKATËSI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

22 Meqenëse nuk dëgjova ndonjë kundërshtim dokumentet do të  
23 riklasifikohen si publike.

24 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Gjykatës  
25 këshillohen]

1 GJYKATËSI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk ka asgjë  
2 nga pjesa e dytë e volumit 1, kështu?

3 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Po. Sepse të dy pjesët që unë  
4 përdora ishin nga volumi 1, nga pjesa e parë e këtij volumit  
5 të librit.

6 GJYKATËSI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A mund ta  
7 korrigjojmë këtë?

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Në këtë rast, në qoftë  
9 se më lejoni të korrigjoj shifrën. Pra, sa i takon volumit të  
10 parë, prova materiale do të marrë numrin P743.1 dhe sa i takon  
11 volumit të dytë, nuk do të caktojmë një numër por, dokumenti  
12 do të vazhdojë të ketë numrin 743.2 dhe 743.3 nuk do të  
13 ekzistojë më meqenëse nuk u kërkua që të pranohet në provë  
14 pjesa e dytë e volumit.

15 GJYKATËSI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitare,  
16 jeni në detyrim që të thoni të vërtetën. Z. Kehoe do të  
17 vazhdojë me pyetjet e tij.

18 Znj. O'Reilly.

19 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, duam që të  
20 konsultohemi më tej me klientin. Do të duam që të na jepet  
21 mundësia nesër për ta diskutuar këtë çështje nesër sepse duket  
22 sikur ka një lloj keqkuptimi. Kështu që do ju kërkoja nëse  
23 mundeni që këtë çështje të mund ta trajtojmë nesër.

24 GJYKATËSI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju kërkoj  
25 ndjesë që ju ndërpres herë pas here, z. Kehoe.

1 Ka një formular që futet në dosje dhe që dorëzohet dhe  
2 kjo nuk është pjesë e dosjes për klientin tuaj. Nuk shoh arsye  
3 se pse duhet t'i kthehemi këtij diskutimi nesër prapë.

4 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, po  
5 përpiqemi që të shmangim nevojën që të mos flasim nesër për  
6 këtë, por nuk mund ta pranoj pa e diskutuar këtë çështje me  
7 klientin që të mos -- që jemi OK të mos e diskutojmë nesër.

8 GJYKATËSI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,  
9 mund të vazhdoni z. Kehoe.

10 Pyetje të palës tjetër nga z. Kehoe:

11 Z. KEHOE: [Përkthim]

12 PY. Mirëmëngjes, se jemi akoma në mëngjes, znj. Mitchell.

13 Përshëndetje, unë jam Gregory Kehoe. Jam përfaqësuesi i  
14 Presidentit Thaçi. Do t'ju bëj pyetje për ca kohë megjithatë,  
15 këto janë pyetje do të cekin fusha të ndryshme, kështu që do  
16 ju kërkoja që të ishit me durim, të tregonit durim. Do të  
17 mbuloj fusha të ndryshme. Nuk është se do të cek çdo gjë që ju  
18 diskutuat me Prokuroren.

19 Megjithatë, dua që të përsëris atë që ju tha edhe  
20 Gjykatësi Smith më herët, në qoftë se nuk e kuptoni një pyetje  
21 ma thoni këtë, ju lutem.

22 Dhe jo vetëm kaq, por për të qenë i mirësjellur me ju  
23 ndonjëherë, përderisa flasim anglisht kemi tendencë që të  
24 flasim mbi njëri-tjetrin. Edhe do të ishte mirë jo vetëm për  
25 përkthyesit, por dua t'ju them që nuk është synimi im që t'ju

1 ndërpres juve kur po flisni. Në qoftë se e bëj këtë gjë se  
2 ndodh ndonjëherë që ta bëj, ju lutem, ma thoni këtë, me vini  
3 në pamje, në dukje, sepse ne jemi të interesuar që të marrim  
4 të gjithë përgjigjen tuaj të plotë. E kuptuat këtë,  
5 Dëshmitare?

6 PË. Po.

7 PY. Dua t'i kthehem kohës kur ju keni shkuar në Misionin  
8 Verifikues të Kosovës dhe ju thatë që fillimisht ka qenë nga  
9 fundi i tetorit dhe nëntorit. A është e saktë kjo?

10 PË. Po.

11 PY. Keni punuar me Ambasadorin Walker aso kohe apo jo?

12 PË. Po.

13 PY. Mendoj që i thatë Prokurorisë që keni qenë e ngushtë, e  
14 keni punuar ngushtë me Ambasadorin Walker?

15 PË. Me Ambasadorin Walker, po.

16 PY. Përveç informimit, dhe sigurisht jam i sigurt që keni  
17 pasur shumë punë për të bërë në momentin kur ju shkuat së pari  
18 për të marrë pjesë në veprimet, veprimtaritë e aktivitetit  
19 tuaj dhe ju nuk është se keni pasur besoj informacion të  
20 mjaftueshëm përpara sesa të shkonit në vend, sa i takon  
21 zhvillimeve. A është e saktë kjo?

22 PË. Po.

23 PY. I keni thënë Prokurorit të Posaçëm në paragrafin 7, të  
24 deklaratës tuaj se shqetësimet tuaja kishin të bënin me  
25 dokumentimin e aktiviteteve ose abuzimeve të drejtave të



1 njeriut që po zhvilloheshin ose që ndodhnin nga serbët, sepse  
2 serbët nuk i dokumentonin këto çështje ose nuk i trajtonin  
3 ato. A është e saktë kjo?

4 PË. Po.

5 PY. Duke shqyrtuar rolin tuaj, me ç'kuptoj unë ju keni pasur  
6 rol menaxhues, drejtues, mbikëqyrës teksa keni qenë atje.

7 Përveç intervistimit herë pas here, rastësor të të ndaluarve,  
8 ju keni pasur rol menaxhues dhe mbikëqyrës, apo jo?

9 PË. Po.

10 PY. Në të përditshmen tuaj ishit personi që bënit intervista,  
11 apo jo?

12 PY. Jo përditë, jo çdo ditë.

13 PY. Kjo ishte detyrë e stafit tuaj për të drejtat e njeriut  
14 dhe personave të ndërlidhjes, apo jo?

15 PË. Po.

16 PY. Raportimet ose raportet që hartonit ju, dhe besoj ja keni  
17 thënë TPNJ-së këtë në deklaratën që keni dhënë në atë kohë.

18 Për procesverbal është në paragrafin 5 të deklaratës tënde.

19 Çështja e rëndësishme për mbledhjen e këtij informacioni ishte  
20 që informacionin ta mblidhnit në mënyrë të paanshme, apo jo?

21 PË. Po.

22 PY. Dhe ju donit që të trajtonit informacionin që ishte i  
23 verifikueshëm, apo jo?

24 PË. Po, për aq sa ishte e mundur.

25 PY. Ndërkohë që stafi kryente detyrat, veprimtaritë e veta në

1 terren, kishte pjesa më e madhe e kontakteve me individët nga  
2 UÇK-ja kryhej nga personat e kontaktit, e ndërlidhjes, jo nga  
3 unë [Sipas përkthimit].

4 PË. Nga të tjerët, jo vetëm nga personat e ndërlidhjes.

5 PY. Po, nga oficerët e ndërlidhjes në të përditshmen, në  
6 veprimtaritë e përditshme të tyre nga oficerët e të drejtave  
7 të njeriut herë pas here, dhe juve pak më rrallë, në mënyrë  
8 sporadike, apo jo?

9 PË. Është e saktë kjo.

10 PY. Pra, ju keni rol menaxhues, drejtues, mbikëqyrës. Punoni  
11 për gjëra në terren me oficerët e ndërlidhjes edhe me oficerët  
12 e të drejtave të njërit dhe ata ju japin informacion ju, apo  
13 jo?

14 PË. Po. Sa i takon dhënies së informacionit në selinë, në  
15 zyrën kryesore, po.

16 PY. Po, domethënë, i jepnit ose furnizonit me informacion ju  
17 në pozicion që kishit, po sigurisht edhe zyrës qendrore, apo  
18 jo?

19 PË. Po.

20 PY. Sa i takon metodologjisë, i keni deklaruar TPNJ-së me  
21 datën 2 korrik 2002, në paragrafin 10, për shkak të numrit --

22 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Është e vështirë që t'ju ndjek në  
23 atë çfarë po thoni se ka shumë dokumente që janë dhënë,  
24 deklarata që janë dhënë për TPNJ-në, kështu që ju lutem, na  
25 jepni numrin e referencës.

1 Z. KEHOE: [Përkthim] Po, keni shumë të drejtë. Dokumenti  
2 IT-005-87 P0226, duhet të jetë e datës 2 korrik 2002.

3 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Faleminderit.

4 Z. KEHOE: [Përkthim]

5 PY. Në këtë deklaratë znj. Mitchell, ju thoni se për shkak të  
6 numrit të madh të ankesave për të drejtat e njeriut të marra  
7 nga divizioni i të drejtave të njeriut, ishte e pamundur që të  
8 kryhen hetime të plota lidhur me të gjitha këto ankesa. Është  
9 e vërtetë kjo?

10 PË. Po.

11 PY. Në të njëjtën mënyrë --

12 Z. KEHOE: [Përkthim] Ju e pasqyroni këtë në volumnin 2 në  
13 librin "Siç është parë, ashtu dhe është treguar", për  
14 procesverbal është dokumenti SITF00001529 deri në 00001871, më  
15 konkretisht në SITF00001553. Do ju kërkoja që ta paraqisni  
16 këtë faqe në ekran, ju lutem. Domethënë, faqen 1553. Mbase ju  
17 dhashë numrin e gabuar? Ju lutem, uleni pak më poshtë faqen.  
18 Pak më lart në faqe, ju lutem.

19 PY. Atëherë, gjashtë rreshta mbi "Metodologjinë". Ku thuhet  
20 që:

21 "Ekipet e të Drejtave të njeriut nuk kanë pasur mundësi  
22 që të rishikojnë të gjitha material apo të hetojnë çdo gjë  
23 është treguar". Dhe thuhet më tej "që nuk ka pasur as kohë dhe  
24 nuk është pjesë e fushës së veprimit, mandatit të OSBE-së që  
25 lejon një nivel të tillë gjithëpërshirjeje."

1 Nuk dua që të jem kritik, por ajo që çfarë dua të them  
2 është që ju keni mbledhur ndoshta në atë kohë informacion për  
3 raportet tuaj, por ndërkohë nuk është se keni pasur gjithë  
4 kohën e nevojshme dhe burimet e nevojshme, apo jo?

5 PË. Po.

6 PY. Nuk është se dua të jem kritik, edhe një herë më lejoni  
7 të theksoj këtë gjë. Por, në një situatë të tillë në ato  
8 zhvillime ishte e pamundur që të jepet një rrëfim  
9 gjithëpërfshirës i asaj çfarë kishte ndodhur, duke marrë  
10 parasysh zhvillimet që ishin atje, duke marrë parasysh  
11 mandatin tuaj kohën që kishit në dispozicion për të mbledhur  
12 gjithë informacionin e nevojshëm. A është kështu, Dëshmitare?

13 PË. Po, e saktë është.

14 PY. Me fjalë të tjera, dhe meqenëse ra fjala po flasim për  
15 volumin 2. Për shembull, shohim rreth 750 pretendime pak a  
16 shumë, pra pretendime që vinin pesë a gjashtë në ditë. Dhe  
17 bëhej fjalë për pretendime të cilat ju përpiqeshit që t'i  
18 verifikonit me aq sa kishit mundësi ju, apo jo?

19 PË. Po.

20 PY. Ju vetë më përpara kishit qenë avokate për çështje  
21 penale, apo jo? Kështu që besoj që për një jurist penal, për  
22 një avokat penal domethënë duhet goxha kohë, të duhen pyetje  
23 themelore që duhet t'i japësh përgjigje të tilla. Për  
24 shembull, se kush ishte personi, kush është viktima, çfarë  
25 motivi fshihet pas veprës, e të tjera. Pra, të gjitha këto

1 pyetje tradicionale juve i keni bërë, si i keni bërë, i keni  
2 bërë si prokurore apo si avokat mbrojtës. Bëhen këto pyetje,  
3 apo jo?

4 PË. Po.

5 PY. Por, në rastet tuaja në pretendimet tuaja ju nuk është se  
6 e keni bërë punë, kështu në këtë trajtë, apo jo?

7 PË. Po.

8 PY. Nëse më lejoni. Shohim, ju kërkoj ndjesë pra, shohim këto  
9 750 hetimet. E kam fjalën për volumin 2, e di që nuk keni pasë  
10 hapësirë mjaftueshëm për t'i vendosur të gjitha në një volum.  
11 Flasim për 750 pretendimet në tërësi, në total të tyre. Këto  
12 janë botuar në dhjetor?

13 PË. Po.

14 PY. Pra, për volumin 2 kemi një periudhë shumë të shkurtër  
15 për të mbledhur informacion nga qershori deri nga fundi i  
16 shtatorit, dhe ju e mblidhni informacionin gjatë kësaj  
17 periudhe dhe pastaj bëni botimin në dhjetor, kështu  
18 Dëshmitare?

19 PË. Po.

20 PY. Përsëri, me gjithë këtë informacion, ju nuk është se  
21 kishit as hetimet as kohën për të bërë hetim të plotë. Nuk  
22 kishit burimet e nevojshme dhe kohën e nevojshme për të bërë  
23 hetim të plotë për këtë lloj informacioni, për të ditur sa i  
24 saktë është ai, por thjeshtë keni përdorur metodologjinë e  
25 përdorimit të burimeve të ndryshme, siç e thatë edhe dje, apo

1 jo?

2 PË. Po.

3 PY. E kuptoj që ju nuk pasur mundësi që të hetoni të gjitha  
4 këto pretendime. Nuk keni pasur as kohën për të hetuar, por si  
5 pasojë ju besoj e pranoni që janë bërë, ose mund të jenë bërë,  
6 gabime për disa prej gjërave që janë pasqyruar në raporte, në  
7 qoftë se e shikojmë historinë nga pas?

8 PË. Nuk e di për çfarë e keni fjalën.

9 PY. Le të flasim pak për krimet e serbëve. E di që keni folur  
10 për krimet e serbëve më tepër në volumnin 1. Domethënë,  
11 megjithatë, përveç pasqyrimin të këtyre krimeve në volumnin 1,  
12 ju keni parë edhe krime të cilët janë kryer nga shqiptarët e  
13 Kosovës, apo jo?

14 PË. [Nuk ka përkthim]

15 PY. Njëra nga temat për të cilat shkruajtët në raportin tuaj,  
16 apo njëra nga pikat në raportin tuaj ka të bëjë me situatën në  
17 barin Panda, me 14 dhjetor 1998.

18 Z. KEHOE: [Përkthim] Është dokumenti SPOE00198098 deri në  
19 198366, faqja që na duhet 198303. Shkojmë në fund të kësaj  
20 faqes.

21 PY. Ka të bëjë me "Vrasjen e civilëve serbë".

22 "Një numër viktimash të paidentifikuara që në dukje të  
23 parë duken vrasje të pashpjegueshme. Ekziston dyshim që forcat  
24 e UÇK-së vranë jo vetëm shqiptarët kosovarë të moderuar, por  
25 gjithashtu edhe serbë që duheshin nga të dy komunitetet.

1 Incidenti në veçanti tërhoqi vëmendjen e ndërkombëtarëve. Me  
2 14 dhjetor kryes të paidentifikuar vranë gjashtë serbë të rinj  
3 të Kosovës në kafenenë Panda në Pejë.

4 A ju kujtohet ky incident?

5 PË. Po, më kujtohet incidenti Panda.

6 PY. Dhe kjo është e përfshirë në librin "E treguar ashtu siç  
7 është parë" në vëllim 1. Kështu?

8 PË. Po.

9 Z. KEHOE: [Përkthim] Kërkoj që kjo pjesë të pranohet si  
10 provë materiale.

11 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Aty ka një citim në lidhje me  
12 burimin e këtij informacioni dhe dua që kjo të përfshihet.

13 Z. KEHOE: [Përkthim] Nuk kemi problem me këtë.

14 GJYKATËSI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vetëm këtë  
15 faqe paraqitni si provë?

16 Z. KEHOE: [Përkthim] Po, vetëm këto fragmente.

17 GJYKATËSI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë,  
18 dokumenti do të pranohet dhe ky dokument që do të pranohet  
19 është ai me numër 198303.

20 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] A mund të edhe një herë  
21 të shtohet kjo faqja të prova materiale tashmë të pranuar me  
22 numër 743.1?

23 Z. KEHOE: [Përkthim] Ashtu siç është më e përshtatshme  
24 për Gjykatën. Ne nuk kemi problem.

25 GJYKATËSI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

1 Z. KEHOE: [Përkthim]

2 PY. Dëshmitare, znj. Mitchell, këtu flisni për vrasjen e  
3 gjashtë civilëve kosovarë, dhe ju përmendi motivet të  
4 hakmarrjes nga ana e shqiptarëve kosovarë. Në shenjë, pra,  
5 hakmarrjeje për vrasjen e 30 anëtarëve të UÇK-së, a është  
6 kështu?

7 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Kundërshtoj, sepse nuk iu tregua  
8 dëshmitares citimi sepse motivi që mund të ishte një hakmarrje  
9 i atribuohet një burimit të informacionit dhe ai nuk na është  
10 thënë.

11 Z. KEHOE: [Përkthim] Mendoj që ky burim është i përmendur  
12 në poshtëshënim.

13 GJYKATËSI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Është  
14 kështu?

15 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Po, është në faqen SPOE00198311.

16 Z. KEHOE: [Përkthim] Nuk më kujtohet numri i  
17 poshtëshimit.

18 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Është poshtëshënimi numër 9.

19 Z. KEHOE: [Përkthim] Po. Burimi është Qendra e të Drejtës  
20 Humanitare. Domethënë, ju e keni pranuar këtë fakt si  
21 përputhës meqë e keni përfshirë në raport?

22 PË. Mendoj që bërë shënim, po.

23 PY. Domethënë, kemi një situatë ku gjashtë të rinj serbë  
24 vriten në një kafene me emrin Panda dhe ju thoni në raport se  
25 konsiderohet se është hakmarrje dhe se një konkluzion i qartë



1 nga e gjithë kjo ishte se UÇK-ja ishte përgjegjëse në një farë  
2 mënyre për këto vrasje.

3 PË. Këto ishin vetëm pretendime, mirëpo, pretendime të  
4 mirëbazuara që kërkonin hetim të mëtejshëm.

5 PY. E kuptoj, mirëpo ju lidhni këtë me motivin për këtë  
6 vrasje, sepse para kësaj kishte ndodhur një vrasje e 30  
7 anëtarët të UÇK-së?

8 PË. Ky ishte përkufizimi më i mirë që mund të bëhej.

9 PY. Në intervistën me SITF-në me 25 qershor 2014, ju theksoni  
10 se:

11 "Zyra në Pejë u përpoq që ta dokumentonte dhe të hetonte  
12 këtë incident dhe kishte një bashkëpunim të dukshëm dhe të  
13 mirë me autoritetet serbe në lidhje me këtë çështje."

14 PË. Po.

15 PY. Ju, domethënë, keni bashkëpunuar, kemi pasur  
16 bashkëpunimin e palës serbe për këtë hetim. A është kështu?

17 PË. Po.

18 PY. A e dini ju se një operacion vrasjet në Panda ishin një  
19 operacion i rrejshëm me motivin që ky krim të përshkruhej, t'i  
20 atribuohet UÇK-së?

21 PË. [Nuk ka përkthim]

22 PY. A e dini ju kush është Vuç Drashkoviqi, faktikisht është  
23 zëvendësministër, kryeministër i Serbisë. E dini si emër?

24 PË. Po.

25 PY. Ai i ka thënë gazete serbe se RDB-ja e udhëhequr nga Rade

1 Markoviqi ka orkestruar këtë masakër nëpërmjet udhëheqësit  
2 paramilitar Milorad Ulemek dhe me urdhër të Slobodan  
3 Milosheviqit. E dini për këtë?

4 PË. Jo, nuk e di për këtë.

5 PY. Ju e dini që qëllimi i këtij sulmi ishte që të  
6 portretizohet UÇK-ja si organizatë terroriste para komunitetit  
7 ndërkombëtar. A është kështu?

8 PË. Jo. Nuk e di këtë, zotëri, më vjen keq.

9 Z. KEHOE: [Përkthim] Në dokumentin DHT02782 deri në 83,  
10 është faktikisht gazeta *Kurir*, ndoshta nuk e shqiptova si  
11 duhet është artikull i datës 18 janar 2004.

12 PY. Përpara se të kalojmë te ky artikull, znj. Mitchell, kjo  
13 ishte një ngjarje mjaft e rëndësishme që kishte peshë në atë  
14 kohë, a është kështu?

15 PË. Po.

16 PY. Dhe çoi në rritjen e zemërimit dhe të fajësimit të  
17 shqiptarëve të Kosovës dhe të UÇK-së për këto vrasje?

18 PË. Nuk e di se çfarë doni të thoni me këtë, zotëri.

19 PY. Desha të them që u rrit niveli i tensionit midis serbëve  
20 dhe shqiptarëve, a është kështu?

21 PË. Po.

22 PY. Dhe konkretisht, midis dhe serbëve dhe UÇK-së, a është  
23 kështu?

24 PË. Po.

25 PY. Dhe kemi këtë artikull të Vuk Drashkoviqit ku thotë që ky

1 ishte një operacion i kryer nga vetë serbët, por me synimin  
2 për t'ia atribuuar atë krim palës tjetër.

3 PË. Unë nuk e kam parë këtë artikull më herët.

4 Z. KEHOE: [Përkthim] Dua ta paraqes artikullin si provë.

5 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Kundërshtoj pranimin e artikullit  
6 meqenëse dëshmitarja thotë se nuk është e njohur me këtë  
7 artikull.

8 Z. KEHOE: [Përkthim] Ky është një artikull i botuar në  
9 janar, 18 janar 2014 dhe është artikull publike.

10 [Anëtarët e Trupit Gjykues këshillohen]

11 GJYKATËSI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po e shikoj  
12 dokumentin, mund ta pranojmë për përmbajtjen e tij, mirëpo jo  
13 domosdoshmërisht për vërtetësinë e asaj përmbajtje.

14 Z. KEHOE: [Përkthim] Do të bëj pyetje shtesë në lidhje me  
15 këtë.

16 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A mund të kërkoj nga ju që  
17 të verifikoni përkthimin sepse në anglisht shkruan për *Legija*,  
18 shkruan në anglisht, *Legion*, që në fakt *Legija* është person  
19 dhe jo grup.

20 Z. KEHOE: [Përkthim] Po, *Legija* është person. Ulemek  
21 *Legija*.

22 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A mund ta dorëzoni një  
23 përkthim të redaktuar, të korrigjuar?

24 Z. KEHOE: [Përkthim] Po, do ta bëjmë këtë. Do ta shënojmë  
25 për identifikim për momentin dhe pastaj do t'i kthehem këtij

1 dokumenti.

2 GJYKATËSI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ashtu do të  
3 veprojmë. Faleminderit.

4 Z. KEHOE: [Përkthim] Kërkoj ndjesë.

5 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Për hir të  
6 procesverbalit këtij dokumenti do t'i jepet numri 1D74 MFI.

7 GJYKATËSI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]  
8 Faleminderit.

9 Z. KEHOE: [Përkthim]

10 PY. Znj. Mitchell, tani do t'ju tregoj një artikull tjetër  
11 prej *Balkan Insight*. A jeni e njohur me këtë institucion?

12 PË. Ndoshta kam qenë në një kohë, mirëpo nuk më kujtohet.

13 PY. E kam të qartë, mirëpo do t'ju tregoj një raport të  
14 publikuar aty, një artikull të datës 2018.

15 Z. KEHOE: [Përkthim] Është me numrin DHT02784 deri në  
16 2789.

17 Kërkoj për përkthyesit që nuk bëjmë pushim midis pyetjeve  
18 dhe përgjigjeve.

19 PY. Mund ta lexoni të gjithë artikullin po që se doni, por  
20 aty citohet se Vladimir Vuçiçeviq, është një prokuror për  
21 krime lufte i Serbisë që: Një, nuk ka pasur shqiptarë në Pejë  
22 në atë kohë; dhe dy, i gjithë informacioni u krye me synimin e  
23 atribuimit të tij palës tjetër. A e dini këtë fakt pra, se  
24 vrasjet në kafenenë Panda ishin një operacion i tillë. Me  
25 synimin e atribuimit të fajit UÇK-së?

1 PË. Jo, nuk e di.

2 PY. Ju publikuat një rrëfim, një storie për vrasjet në Panda,  
3 që ju besonit se ishit i mundshëm.

4 PË. E keni fjalën për raportin?

5 PY. Po. Dhe në atë raport, pra është faktikisht një deklaratë  
6 ku thuhet se u vranë gjashtë të rinj serbë dhe se mbas këtyre  
7 vrasjeve ishin UÇK-ja dhe shqiptarët e Kosovës. Kjo është  
8 deduktimi që mund të bëhet prej kësaj që thuhet këtu. A është  
9 kështu?

10 PË. Po.

11 PY. Në qoftë se këto artikuj janë të vërtetë, deduktimi që  
12 keni bërë ju, konkluzioni që keni nxjerrë në raport, atëherë  
13 është i pasaktë?

14 PË. Po. Ashtu del në qoftë se informacioni në artikuj është i  
15 saktë.

16 PY. Dhe besoj që nuk kishit mundësi të bëni hetime në atë  
17 kohë, mirëpo ky incident është i mbushur përplot me emocione  
18 dhe kjo është mjaft me rëndësi për në atë kohë dhe ju duhej të  
19 hetonit siç duhet në çdo moment situatat, a është kështu?

20 PË. Po.

21 PY. Serbët ama kanë bërë dhe operacione të tjera të sajua  
22 maskuese të këtij lloji, apo jo?

23 PË. Operacione maskimi, s'e kuptoj tamam.

24 PY. Në fakt është term ushtarak dhe ju kërkoi unë ndjesë. Do  
25 të thotë që serbët kryejnë një vepër penale, siç ishte rasti i

1 vrasjeve në kafenenë Panda, dhe këtë ia vënë fajin një personi  
2 tjetër. Kjo ka ndodhur vazhdimisht, apo jo?

3 PË. Nuk do të thoja me kaq siguri "vazhdimisht". Këto raporte  
4 janë të mbështetura në pretendime.

5 PY. Po pikërisht në pretendime. Qartë. Kur i hedh pretendimet  
6 në një raport ju thatë që pasi i merrnit pretendimet ju vetë  
7 nuk bënit hetime të mëtutjeshme?

8 PË. Jo, ju kërkonim të tjerëve ta bënin.

9 PY. Po, pra, organizatave të tjera të zbatimit të ligjit.

10 Z. KEHOE: [Përkthim] Po shohim, për shembull, vëllimin e  
11 parë të raportit "Siç është parë e siç është treguar" që është  
12 SPOE00198098 dhe na intereson faqja 198305.

13 I nderuar Gjykatës, do të doja që artikulli i *Balkan*  
14 *Insight* të pranohej si provë.

15 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime.

16 GJYKATËSI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë,  
17 materiali me numër DHT02784 deri në 02789 pranohet. Ju lutem,  
18 t'i jepni numrin e provës materiale.

19 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,  
20 merr numrin e provës materiale 1D75. Dhe më thoni nëse duhet  
21 nëse duhet të klasifikohet si publike.

22 GJYKATËSI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]  
23 Faleminderit. Vazhdoni.

24 Z. KEHOE: [Përkthim]

25 PY. Këtu flasim për ndalimin, këtu në krye të faqes flitet

1 për ndalimin e dy gazetarëve të *Tanjug*-ut. E shihni?

2 PË. Po.

3 PY. Këtu thuhet që:

4 "Gazetarët e *Tanjug*-ut, agjencisë shtetërore jugosllave u  
5 rrëmbyen nga anëtarë të UÇK-së më 18 tetor 1998. Dhe më në  
6 fund u liruan pas dy muajsh, e mundësuar kjo nga Shefi i  
7 Misionit të MVK-së së OSBE-së".

8 Z. KEHOE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ndërkohë që po  
9 flasim këtë, do të toja që këto tri rreshta në krye të faqes  
10 të pranoheshin si prova.

11 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Nuk kam kundërshtime, po do ju --  
12 do të sugjeroja që t'i tregonit edhe poshtëshënimet  
13 dëshmitares në qoftë se do të bëni pyetje për këto tri  
14 rreshta.

15 Z. KEHOE: [Përkthim] S'kam asnjë kundërshtim unë që të  
16 pranohet edhe poshtëshënimi.

17 GJYKATËSI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju kërkoni  
18 që të kërkohet që të pranohet vetëm tre rreshta?

19 Z. KEHOE: [Përkthim] Po, tri rreshta?

20 GJYKATËSI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë, tri  
21 rreshtat bashkë me poshtëshënimin pranohen.

22 Z. KEHOE: [Përkthim] Ky është dokumenti më i shkurtër që  
23 do të kërkohet ndonjëherë të pranohet.

24 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Ju lutem që këto tre  
25 rreshta ta bashkëngjisim provës materiale P743.1.

1 Z. KEHOE: [Përkthim] Për mua s'ka asnjë problem.

2 PY. Do t'ju tregoj tani një dokument që është pranuar si  
3 provë dhe mban numrin 1D59. Kur po shihnit rastin e këtyre dy  
4 gazetarëve, pra, po ndiqnit rastin e këtyre dy gazetarëve edhe  
5 hodhët këtë informacion në këtë raport, ju nuk bëtë ndonjë  
6 hetim se kush ishin këta gazetar, apo jo?

7 PË. Nuk jam e sigurt. Duhet të shoh poshtëshënimin.

8 PY. Po patjetër.

9 Z. KEHOE: [Përkthim] Poshtëshënimet -- sapo më informuan  
10 që poshtëshënimet gjenden në faqen 311, 312 të këtij  
11 dokumenti.

12 PY. Znj. Mitchell, nëse kërkon informacione shtesë më thoni,  
13 pa problem.

14 Z. KEHOE: [Përkthim] Besoj se këtu kemi poshtëshënimin 19  
15 dhe 20. Për këto bëhej fjalë. Shkoni në faqen tjetër.

16 PY. Informacioni që keni përfshirë në raport ka ardhur nga  
17 *Humanitarin Law Centre*, nga një raport i tyre. A e kam kuptuar  
18 drejtë?

19 PË. Po.

20 PY. Atëherë, mirë e kuptuar që po, është edhe *Human Rights*  
21 *Watch* këtu. Dhe bazuar në poshtëshënimet ju nuk keni bërë  
22 ndonjë hetim të mëtutjeshëm se kush ishin këta persona?

23 PË. Korrekt.

24 Z. KEHOE: [Përkthim] Shohim tani provën materiale për të  
25 cilën po flisja më herët, që është 1D59.



1 PY. Znj. Mitchell, kjo ishte vetëm për mua dhe për ty.

2 Z. KEHOE: [Përkthim] Ky është një dokument i pranuar si  
3 provë. Shkojmë në faqen tjetër.

4 PY. Dhe është për një nga këto reporterët e *Tanjug*-ut me  
5 emrin Vladimir Dobriçiç, i njohur ndryshe si Kica. Që  
6 pretendonte se ishte fotoreporter i *Tanjug*-ut, kur në të  
7 vërtetë ai ishte kyçur në një grup vullnetarësh në Kroaci dhe  
8 ka kryer një sërë vrasjesh. Dhe thuhet:

9 "Për shkak të veprimtarive kriminale dhe vrasjeve që ka  
10 kryer, sidomos afër Skabrënjës ku u vranë me dhjetëra civilë u  
11 vendos një njësiti i tij të mbyllef". Njësiti ku ishte ky  
12 person.

13 Dhe është përshkruar nga hetuesit e TPNJ-së si një çetnik  
14 i egër dhe ka qenë deklaratë e TPNJ-së kjo dhe e pranuar si  
15 dokument.

16 Ju kur bëtë raportin, a bëtë ndonjë analizë për këtë  
17 zotin Dobriçiç të kuptonit a ka qenë ndonjëherë ky person i  
18 përfshirë në veprimtari kriminale në Kroaci dhe në Bosnje?

19 PË. Kështu.

20 PY. Flasim pra për këto operacionet e maskuara. Kushdo që e  
21 shikon këtë për të kuptuar a ka pasur veprimtari kriminale, ju  
22 pajtoheni me mua të shikojmë një herë kush janë këto viktima,  
23 çfarë të shkuare kanë këta persona. Është e rëndësishme.

24 PË. Kështu është.

25 PY. Nuk po them që duhet ta bënit ju personalisht, po duhet

1 analizuar informacioni, apo jo në një çështje penale e jo  
2 thjeshtë të marrësh e të kopjosh informacion?

3 PË. Po mendohem - po. E pranoj. Po hezitoj.

4 PY. Ne folëm dhe thamë Dobriçiqi nuk ishte fotoreporter i  
5 *Tanjug*-ut. Folëm edhe për operacionin e maskimit të kafenesë  
6 Panda. Dhe kemi folur për informacione të tjera të sajua, të  
7 trilluara që burojnë nga serbët, për shembull, hedhja e  
8 pamfleteve në shqiptarët e Kosovës.

9 Po ua bëj më të lehtë punën mund ta shohim më konkretisht  
10 këtë gjë në raport.

11 PË. Në rregull.

12 Z. KEHOE: [Përkthim] Në rregull atëherë. Shohim  
13 dokumentin SPOE00198372. Ju kërkoj ndjesë se po presim  
14 ndërkohë që të shfaqet dokumenti në ekran.

15 Për hir të kohës unë mund ta lexoj, mbase është më e  
16 thjeshtë.

17 Atëherë, shkojmë pak më poshtë në raport. Kur flitet këtu  
18 Dhjetori i 1998.

19 PY. "Në dhjetor të 1998-shqip, u gjetën pamflete në Istiniq  
20 [Sipas përkthimit] ku dhe përmbanin kërcënime për vdekje që  
21 pretendoj se ishin lëshuar nga shtabi i UÇK-së. MVK-ja e OSBE-  
22 së u informua dhe u këshillua se shqiptarët e Kosovës të asaj  
23 zone nuk besonin se këto pamflete ishin autentike dhe i  
24 mendonin që ishte një trillim i përdorur nga policia serbe për  
25 të frikësuar popullatën."

1 A ju kujtohet t'ju jetë raportuar diçka e tillë?

2 PË. Nuk më kujtohet, por kam besim që në qoftë se është në  
3 raport i bie që e kemi marrë këtë informacion.

4 PY. Pra, informacioni që kemi ju OSBE-ja keni dokumentuar që  
5 janë hedhur pamflete të rreme për trembur popullatën, të  
6 kanosnin, pra, popullatën vendore dhe se vetë këta të fundit  
7 besonin se i kishte hedhur policia serbe për t'i frikësuar.

8 PË. Po.

9 Z. KEHOE: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, kërkoj që kjo të  
10 pranohet si provë.

11 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Nuk kundërshtoj. Edhe një herë unë  
12 sugjeroj të përfshini edhe poshtëshënimin që është me numër  
13 25. Ajo që është cituar gjenden në faqen SPOE00198378.

14 Dhe ky është fragmenti i parë i pjesës së -- pra, kjo  
15 është pjesa e dytë e vëllimit 1, më falni, dhe ende nuk kam  
16 marrë numrin e provës materiale. Nuk kemi kundërshtim në qoftë  
17 se do të jepni numrin 743.3. Megjithatë, këtë e vendos Trupi  
18 Gjykues.

19 GJYKATËSI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] SPOE00198372  
20 bashkë me poshtëshimin me numrin 25 pranohen si prova.

21 Një çast ju lutem, një çast.

22 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti merr numrin  
23 P743.3

24 Z. KEHOE: [Përkthim]

25 PY. Folëm më herët për vrasjet e Reçakut. Dhe në atë situatë

1 serbët u përpoqën t'i mbulonin këto vrasje, apo jo?

2 PË. Po.

3 PY. Erdhën, morën trupat që kishin vrarë dhe ku i çuan?

4 PË. Tek morgu në Prishtinë.

5 PY. Dhe këtë e bënë serbët, apo jo?

6 PË. Po.

7 PY. Në fakt, gjatë kësaj periudhe kohore serbët i çuan në

8 Prishtinë, pra, i morën dhe i çuan në Prishtinë që i varrosën

9 pastaj, apo jo?

10 PË. Nuk më kujtohen këto hollësi.

11 PY. Rruga mes -- do të flasim edhe për këtë. E gjithë rruga

12 nga Reçaku deri në Prizren në janar 1999 ka qenë tërësisht e

13 kontrolluar nga armata jugosllave dhe nga MUP-i apo jo?

14 PË. Nga Prizreni?

15 PY. Po pra, nga Prizreni në Prishtinë, e gjithë kjo rrugë

16 komunikuese ka qenë e gjitha rruga komunikuese mes Prizrenit

17 dhe Prishtinës ka qenë e kontrolluar nga forcat serbe.

18 PË. Po.

19 PY. Pra, kur folëm trupat, trupat janë çuar nga Reçaku në

20 Prishtinë dhe pastaj po serbët i kthyen?

21 PË. Po nuk më kujtohet a ka qenë MVK-ja, kanë qenë anëtarët e

22 familjes, a ka qenë MVK-ja me serbët apo anëtarë të familjes.

23 Më vjen keq nuk më kujtohet kush i ka kthyer trupat.

24 PY. Po ju them uën që MVK-ja s'ka pasur asnjë farë lidhje

25 kthimin e trupave në Reçak. Gjithashtu ka pasur operacione të

1 tjera maskuese për krime të tjera që unë dua t'i trajtoj  
2 shkurtimisht me ju.

3 Z. KEHOE: [Përkthim] Dhe kjo është në vëllimin 1, SPOE me  
4 numrin e faqjes 198397.

5 PY. Shohim:

6 "Më 10 mars trupi i një shoferi taksie shqiptar i Kosovës  
7 46 vjeç nga Gjakova u gjend pranë Meqes, 10 km larg Gjakovës  
8 pranë një kodre nga beli [Sipas përkthimit] -- nga beli, pranë  
9 Drinit të Bardhë. Trupi kishte plagë arme në kraharor dhe në  
10 kokë dhe makina e padëmtuar u gjend pranë. Policia tërhoqi  
11 trupin dhe informoi familjen. Më pas MVK-ja e OSBE-së mori  
12 pjesë në vendngjarje dhe bëri intervistat."

13 Kur thotë policia këtu bëhet fjalë për policinë serbe?

14 PË. Po, është e drejtë.

15 PY. "Nga intervistat doli se më 9 mars shoferi i taksisë  
16 kishte një pasagjer nga Sverka (Klinë), por nuk u pa më pas  
17 kësaj. Policia kishte intervistuar disa herë më përpara këtë  
18 person lidhur me disa pretendime se kishte transportuar  
19 anëtarë të UÇK-së."

20 Dhe thuhet:

21 "Burimet e UÇK-së po ashtu raportojnë se viktimia ua  
22 kishte thënë shokëve tri ditë para vdekjes se e kishte kanosur  
23 policia", pra policia serbe, dhe "i kishin thënë 'në qoftë se  
24 vazhdon të transportosh', [pra e kishte fjalën për UÇK-në],  
25 'do ju vrasë UÇK-ja!'"

1 Ky ishte një kërcënim që ia ka bërë policia serbe  
2 shoferit të taksisë sepse ai transportonte anëtarë të UÇK-së  
3 dhe në fakt e vranë dhe sipas informacionit që kishin, kishte  
4 ai vetë, Serbia synonte t'ia vinte fajin UÇK-së, kështu?  
5 PË. Po, kështu thuhet.

6 Z. KEHOE: [Përkthim] Shohim sërish një pjesë në vëllimin  
7 1 që është në faqe SPOE - ju kërkoh ndjesë - e tërheq, 198402.  
8 Shohim më poshtë, shkojmë te paragrafi në mes të faqe.

9 PY. Diku në mes të paragrafit thuhet:

10 "Një mësues nga Krusha e Vogël e Prizrenit u arrestua në  
11 urën në Rugovë dhe u rrah nga policia në një stacion policie,  
12 në podrum të një stacion policie."

13 Edhe në këtë rast bëhet fjalë për policinë serbe?

14 PË. Po.

15 PY. "Më pas u transferua në katin e tretë, e rrahën me  
16 lopata, e shkelmuan, sidomos në veshka. Dhe i bënë pyetje të  
17 këtij lloji: 'Çfarë gjuhe ke përdorur ti kur ke qenë në klasë?  
18 A ka përdorur kurikulën serbe apo kosove, të Kosovës?' Po  
19 ashtu e kërcënuan se do t'i vishnin uniformën e UÇK-së do ta  
20 çonin në pyll dhe do ta vrisnin në qoftë se nuk përgjigjej."

21 Kemi këtu rastin e një mësuesi që e kanë kërcënuar që i  
22 kanë veshur -- e kanë kërcënuar se do t'i vishnin uniformën e  
23 UÇK-së dhe do ta qëllimin me armë. Ky është pretendimi këtu.

24 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Pretendimi është që -- ishte një  
25 kërcënim, nuk ka ndodhur se u keqkuptuar.

1 Z. KEHOE: [Përkthim] Po, po, e kërcënuan se do ta bënin,  
2 jo se e bënë.

3 PË. Mos më keqinterpretimi hezitimin tim sepse nuk është se  
4 po dëgjoj përkthimin.

5 PY. Më falni, po bëj pauzë për përkthimin. Në rregull. Ju  
6 kishit informacion -- kalojmë tek aspekti tjetër. Flasim për  
7 aspektin tjetër. Kur thoni që mbërritën në pikat e kontrollit  
8 dhe njerëzit detyroheshin që të vishnin uniformat e UÇK-së.

9 Z. KEHOE: [Përkthim] Do t'i kthehem volumit 1 dhe më  
10 konkretisht e kam fjalën për dokumentin SPOE00198435.

11 Përsëri do të përpiqem të bëj më të mirën.

12 Ju kërkoj ndjesë. Megjithatë përpara sesa të filloj me  
13 këtë dokument dua që të regjistroj si provë materiale  
14 fragmetin e mëhershëm, të mëparshëm që përdora. Mendoj që janë  
15 dy fragmente jo një. Nëse më lejoni dua që t'i paraqes ato për  
16 prova materiale.

17 GJYKATËSI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.  
18 Njëri prej tyre SPOE00198397 apo jo? Ka kundërshtim.

19 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Jo, nuk kemi kundërshtim për këtë.

20 GJYKATËSI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] I dyti  
21 dokument është SPOE198402. Të dy pranohen.

22 Prisni derisa të caktohet një numër prove materiale, z.  
23 Kehoe.

24 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do  
25 të marrin numrin e provës materiale P743.3.

1 GJYKATËSI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të  
2 vazhdoni z. Kehoe.

3 Z. KEHOE: [Përkthim]

4 PY. Znj. Mitchell, shikoni dokumentin që keni në ekran.

5 Z. KEHOE: [Përkthim] Pra, është paragrafi i fundit që  
6 fillon "Që kishte..." në qoftë se Sekretarja mund të kalojë më  
7 poshtë në faqe.

8 PY. Fillon që "Kishte shumë ankesa..." dhe "Kishte pretendime  
9 të keqtrajttimeve, për konfiskime të paligjshme në pikat e  
10 kontrollit për ryshfete".

11 Këtu flitet për veprime që kanë ndodhur në pikat e  
12 kontrollit serbe, apo jo, Dëshmitare?

13 PË. Po.

14 PY. Të kalojmë tek gjysma e dytë e paragrafit, thuhet:

15 "Në pikën e kontrollit ishte një i ri i cili u detyrua që  
16 të futej në ndenjëset e pasme të automjetit të tij nga  
17 oficerët e policisë dhe atë e vozitën në një vend aty afër në  
18 një pyll aty afër. I riu u detyrua që të vishte një uniformë  
19 të UÇK-së dhe që të mbante në dorë një armë ku oficerët e  
20 policisë i bënë fotografi atij. Pas kësaj gjëje, pra pas këtij  
21 veprimi ata i morën uniformën dhe pushkën dhe e rrahën. I riu  
22 nuk u lejua që të largohej dhe premtoi që do t'i paguante  
23 oficerëve të policisë 20.000 marka gjermane të nesërmen."

24 Pra, në këtë rast që ju përshkruani një person detyrohet  
25 që të veshë uniformën e uniformën e UÇK-së. A keni qenë në



1 dijeni të këtij incidenti në atë kohë, Dëshmitare? Dhe në  
2 qoftë se doni mund të shikojmë edhe një faqe të mëparshme. Për  
3 shembull, është kjo pjesa që lexon këtu që:

4 "Ishte një rast i dallueshëm në shkurt që ka bërë me një  
5 të ri i cili po voziste nga Kasko [Sipas përkthimit] ... në  
6 Gjilan dhe që u ndalua nga policia, nga një oficer policie."

7 A ju kujtohet gjë kjo?

8 PË. Po, në mënyrë të vagullt. Kur e lexoni më kujtohet diçka.

9 PY. Pra, ju keni pasur informacion që policia i detyronte  
10 njerëzit, individë të caktuar që të vishnin uniformat e UÇK-  
11 së, kështu Dëshmitare?

12 PË. Po.

13 Z. KEHOE: [Përkthim] Le të shohim përsëri volumin 1, për  
14 procesverbal është dokumenti SPOE00198437 deri në 438. Besoj  
15 duhet të jetë diku nga fundi i faqes.

16 Nuk e di në qoftë se mund të provoj pranim në provë  
17 materiale të paragrafit të mëparshëm përpara sesa të vazhdoj  
18 me atë paragraf.

19 GJYKATËSI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë  
20 kundërshtim, por kërkojmë që të përfshihen dhe poshtëshënimet.

21 Z. KEHOE: [Përkthim] Po e them për momentin që për të  
22 gjitha fragmentet, të gjitha paragrafët që do të kërkoj që të  
23 pranohen në prova materiale do të përfshijnë edhe shënimet që  
24 të mos i diskutojmë më çështjen e poshtëshënimeve.

25 GJYKATËSI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

1 Dokumenti SPOE00198435 plus poshtëshënimi pranohen.

2 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Do të marrë numrin e  
3 provës materiale P743.3.

4 Z. KEHOE: [Përkthim]

5 PY. Në fund në paragrafit, znj. Mitchell, shkruhet si më  
6 poshtë:

7 "Një refugjate raportoi që bashkëshorti i saj kishte vënë  
8 re në dritare sesi policët kishin rrahur fqinjin e saj, një  
9 udhëheqës lokal të një partie më të vogël politike përpara  
10 shtëpisë së saj, në datën 22 maj."

11 Po flasim për 1998-n këtu. E tërheq këtë.

12 "Pra, ata kanë vendosur armë, dy granata, një armë  
13 automatike, uniforma të UÇK-së në shtëpinë e tij dhe e kanë  
14 detyruar shqiptarët e Kosovës nga rrugët që të 'verifikojnë'  
15 përmes nënshkrimit të një dokumenti. Ky lloj fabrikimi  
16 dokumentacioni është parë që të ndodhte nga liderë shqiptarë  
17 të Kosovës të organizatave politike të Gjilanit."

18 Tani, ju keni pasur një zyrë në Gjilan, dhe besoj që jeni  
19 informuar për incidentin, apo jo, Dëshmitare?

20 PË. A mund të më thoni vitin, ju lutem?

21 PY. Ja do ta kontrolloj do ta shoh tani vitin e do ta them.

22 PY. Në qoftë se më lejoni që të shikoj citimin.

23 PY. Po, patjetër.

24 Z. KEHOE: [Përkthim] Citimi është 29 [Sipas përkthimit].

25 Mund të shkojmë te kjo pjesa. Te poshtëshënimi 29, 28 ju

1 lutem.

2 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] A mund të më jepni  
3 numrin e ERN për poshtëshënimin?

4 Z. KEHOE: [Përkthim] Numri ERN është 444 për këtë faqe.  
5 Poshtëshënimi është me numrin 28, z. Sekretare e seancës.  
6 PY. Nuk e di nëse ju ndihmova ndopak.

7 PË. Kjo më tregon që këto janë deklarata të bëra nga  
8 refugjatët gjatë intervistimit në kampet e refugjatëve gjatë  
9 fushatës.

10 PY. Dhe kjo ishte një deklaratë që është dhënë prej një prej  
11 refugjatëve që kishte të bënte me uniformat e UÇK-së në këtë  
12 shtëpi, vendosjen e uniformave të UÇK-së në shtëpi, apo jo?

13 PË. Po. Në poshtëshënimin 28 tregohet që kjo është një  
14 intervistë që mund të jetë marrë në një kamp në Maqedoni.

15 Z. KEHOE: [Përkthim] Z. Të nderuar Gjykatës, kërkojmë që  
16 këtë pjesë ta pranojmë si provë materiale.

17 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Nuk kundërshtojmë, por dëshirojmë  
18 që dëshmitarja ta qartësojë vitin. Besojmë që dimë se për  
19 cilin vit bëhet fjalë, megjithatë do të ishte mirë që ta  
20 sqaronte dhe ta thoshte për procesverbal.

21 DËSHMITARJA: [Përkthim] Bëhet fjalë për vitin 1999.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti  
23 SPOE00198437 deri në 438 plus dhe shënimi në faqen 28 në  
24 ERN444 pranohet si provë materiale.

25 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,

1 pranohen dhe marrin numrin e provës materiale 743.3.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju kërkoj  
3 ndjesë se nuk thashë që pranohen si prova materiale.

4 Z. KEHOE: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.  
5 PY. Kam një referencë të fundit që ka të bëjë me të njëjtën  
6 dhe bëhet fjalë për volumin në dokumentin SPOE00198652. Është  
7 në krye të faqes. Do të kërkoja që të kalonim tek faqja  
8 përpara nëse është e mundur. Edhe pak më sipër në faqe.

9 PY. Është në këtë zonë.

10 Z. KEHOE: [Përkthim] Ju lutem, të kalojmë pak më poshtë  
11 në faqe.

12 PY. Kam përshtypjen që bëhet fjalë për këtë zonën me 29 mars.  
13 Mund t'i hidhni një sy dhe mund të kalojmë te faqja tjetër, ë  
14 fillim fare të faqes, pra thuhet që:

15 "Të njëjtën ditë gjatë 'policë'..."

16 "Policë" vendoset në thonjëza pse e diskutuat çështjen e  
17 policisë me Prokurorinë edhe thatë që kur e vendosni në  
18 thonjëza, shpjeguat që bëhet fjalë për persona të cilët  
19 hiqeshin ose shtireshin që ishin policë dhe që nuk kishin të  
20 drejtë të ushtronin këtë lloj aktiviteti, apo jo Dëshmitare?

21 PË. Po.

22 PY. Thuhet në këtë raport që:

23 "Të njëjtën ditë gjashtë 'policë' me uniforma me lara me  
24 armë automatike dhe granata u futën në ndërtesë edhe i dëbuan  
25 personat që qëndronin aty. Dy nga kryesit jetonin në të

1 njëjtën ndërtësë. Njeri jetonte në një shtëpi aty ngjitur. Një  
2 tjetër qeraxhi bashkëpunoi me policinë dhe shkroi 'UÇK' në  
3 dyert e shqiptarëve të Kosovës." Thuhet më tej që "I  
4 intervistuari, personi që u mor në intervistë nuk i kishte  
5 parë asnjëherë këta personat që kishin veshur uniformë".

6 Z. KEHOE: [Përkthim] Në qoftë se do të shkojmë tani te  
7 poshtëshënimi 86, është në faqen 658. Ju kërkoj ndjesë se  
8 është poshtëshënimi 68 dhe jo 86.

9 PY. Ju ndihmon kjo, ju kujtohet kjo intervistë me një  
10 refugjat?

11 PË. Po, i nderuar Gjykatës. Poshtëshënimi 86 ka të bëjë me dy  
12 deklarata të marra nga një refugjat në Maqedoni.

13 PY. Pra, kemi një situatë ku njerëzit thonë që vinin njerëz  
14 që pretendonin që të ishin të UÇK-së, a ishin të veshur, pra,  
15 trokisnin në dyert e tyre duke u hequr, duke u shtirur që  
16 ishin të UÇK-së, apo jo?

17 PË. Po.

18 PY. Po ata e dinin që këta njerëz me uniforma nuk i kishin  
19 parë asnjëherë më përpara, apo jo, Dëshmitare?

20 PË. Po.

21 PY. Po se këtu kështu thuhet.

22 "I intervistuari tha që nuk i kishte parë asnjëherë këta  
23 njerëz më përpara..."

24 PË. [Nuk ka përkthim]

25 PY. Përveç kësaj periudhe kohe kur keni qenë atje.

1 Z. KEHOE: [Përkthim] Dhe meqenëse ra fjala dua që ta  
2 pranojmë si provë materiale përpara se të vazhdojmë me pyetjen  
3 tjetër.

4 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Nuk kam kundërshtim. Vetëm  
5 thjeshtë dua që të kërkoj që të fillojë leximi pjesa e  
6 mësipërme. Domethënë, të fillojë në faqen SPOE00198651 në fund  
7 dhe pastaj të vazhdohet me paragrafin e fundit, në fillim të  
8 faqes 652, në fund të shënimit.

9 Z. KEHOE: [Përkthim] Mund ta sqaroj këtë gjë në pyetjet  
10 plotësuese Prokurorja në qoftë se ka ndonjë problem.

11 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Besoj se është një dokument i cili  
12 u përdor në pyetjet kryesisht prej Prokurorisë.

13 Z. KEHOE: [Përkthim] Në rregull. Mund ta pranojmë edhe  
14 atë.

15 GJYKATËSI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti  
16 SPOE00198651 deri në 652 pranohet së bashku me shënimin 86, në  
17 faqen 658.

18 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Merr numrin e provës  
19 materiale P743.3.

20 Z. KEHOE: [Përkthim]  
21 PY. Përveç elementëve për të cilët ju diskutuat, ju ishit në  
22 dijeni të faktit që autoritetet serbe, armata serbe,  
23 paramilitarët serbë dhe MUP-it ishin të armatosur dhe po i  
24 armatosnin civilët serbë, apo jo?

25 PË. Po.

1 PY. Dhe këto civilë ishin të përfshirë në aktive, veprimtare  
2 penale, kriminale duke mbështetur MUP-informacion dhe  
3 paraushtarakët dhe armatën serbe, apo jo?

4 PË. Po.

5 PY. Si rezultat i kësaj dhe dua që t'ju tërheq vëmendjen për  
6 të parë volumin 1, dokumentin SPOE00198149. Paragrafi që  
7 fillon me këtë citim: "Njësitë paramilitare janë të vështira  
8 për t'u daluar...". Nuk ishte dokumenti në ekran. Ju kërkoj  
9 ndjesë për këtë. Është paragrafi i plotë, paragrafi i parë i  
10 plotë në faqen që keni përpara.

11 PË. Po.

12 PY. "Njësitë paramilitare janë të vështira për t'u  
13 përcaktuar dhe për t'u njohur. Në disa raste ka të ngjarë që  
14 ka paqartësi për të dalluar ndërmjet civilë të armatosur  
15 lokalë dhe paramilitarëve të organizuar që vinin nga jashtë  
16 Kosovës."

17 Ky ka qenë fakt, apo jo Dëshmitare gjatë të gjithë kohës  
18 që ju keni qenë pjesë e Misionit Verifikues derisa u larguat  
19 në mars të 1999? Është e vërtetë kjo?

20 PË. Po.

21 PY. Sa i takon çështjes së luftëtarëve dhe të joluftëtarëve  
22 duke marrë parasysh që ata po jepnin armë civilëve, domethënë  
23 civilët që u armatosën u bënë luftarakë, luftëtarë, apo jo?

24 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Kundërshtojmë janë terma dhe  
25 koncepte ushtarake.

1 GJYKATËSI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet  
2 mund t'i përgjigjeni.

3 PË. Po.

4 Z. KEHOE: [Përkthim]

5 PY. Pra, ishte MUP-i, paramilitarët, civilët e armatosur, të  
6 gjithë që merrnin pjesë në sulme ndaj shqiptarëve të Kosovës,  
7 apo jo?

8 PË. Po.

9 PY. Tani le të kalojmë te faqja tjetër. Fillon me "uniformat  
10 e bardha". Për procesverbal është faqja pasuese që është  
11 198150. Është ky informacioni në kutinë në faqen që keni  
12 përpara: "Njohja dhe dallimi ndërmjet kryesve: uniformat".

13 "Atëherë, për uniformat e bardha, të shqiponjave të  
14 bardha ato kanë qenë në ngjyrë kremi në njësitë SAJ, civilët  
15 lokalë të armatosur mund të përziheshin me njësitet  
16 paramilitare *ad hoc* (me paramilitarët e Arkanit). Pra, me pak  
17 fjalë rregulli i fiksuar për identifikimin e kryesve nga  
18 uniformat ishte ç'orientues, pra nuk mund të bëhej dot  
19 identifikimi vetëm nga uniformat."

20 Besoj që pajtoheni me mua lidhur me këtë, apo jo?

21 PË. Po, sa i takon forcave serbe.

22 Z. KEHOE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj pranimin  
23 në prova materiale të këtyre dy fragmenteve të fundit.

24 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Nuk kam kundërshtim.

25 GJYKATËSI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti



1 SPOE00198149 dhe dokumenti tjetër, në mos gabohem është  
2 P198150, të dy dokumentet pranohen në prova materiale.

3 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do  
4 të marrin numrin e provës materiale P743.1.

5 Z. KEHOE: [Përkthim]

6 PY. Ju i thatë ZPS-së në diskutimet me të që pasi u larguat  
7 në mars 1999, jo vetëm ju, domethënë po ju edhe staf i  
8 konsiderueshëm i Misionit Verifikues ka zhvilluar intervistime  
9 në Maqedoni dhe në Shqipëri. A është e vërtetë kjo,  
10 Dëshmitare?

11 PË. Po.

12 PY. E di që po prisni për përkthyesit. Megjithatë, më lejoni  
13 t'ju tregoj një tjetër dokument.

14 Z. KEHOE: [Përkthim] Dhe besoj që do të jetë dokumenti i  
15 fundit përpara pushimit, të nderuar Gjykatës. Është dokumenti  
16 SPOE00198307.

17 PY. Është paragrafi, po paragrafi në fund në këtë faqe. Po,  
18 paragrafi i fundit. Në raport, në volumnin 1 shkruhet si më  
19 poshtë:

20 "Nga 2764 intervista me kryesisht shqiptarë të Kosovës,  
21 me refugjatë shqiptarë të Kosovës të kryera nga OSBE-KVM,  
22 kishte raporte të shumta të civilëve serbë që merrnin pjesë  
23 sulme kundër popullsisë shqiptare të Kosovës në periudhën nga  
24 20 mars deri në 8 qershor 1999."

25 A është një reflektim i qartë ky i asaj që çfarë po

1 ndodhte në këtë periudhë që popullsia serbe ishte e përfshirë  
2 në mizoritë ndaj popullsisë shqiptare?

3 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Është mbivlerësim, nuk bëhet fjalë  
4 për të gjithë popullsinë serbe.

5 Z. KEHOE: [Përkthim] Ishte pyetje.

6 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Është keqinterpretim i fakteve.

7 GJYKATËSI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet  
8 kundërshtimi, mund t'i përgjigjeni.

9 DËSHMITARJA: Ju kërkoj ndjesë, e harrova fare pyetjen  
10 tani.

11 Z. KEHOE: [Përkthim]

12 PY. Megjithatë, është fakt apo jo që refugjatët që keni  
13 intervistuar ju kanë thënë në shumë raporte të shkruara prej  
14 jush që civilë të armatosur serbe merrnin pjesë në mizori, dhe  
15 mizoritë ishin në vijim e sipër, vazhdonin në Shqipëri përpara  
16 sesa ju të largoheshit në mars 1999?

17 PË. Jo në Shqipëri në Kosovë. Kjo është e saktë.

18 Z. KEHOE: [Përkthim] Në rregull, besoj që jemi në një  
19 moment të përshtatshëm për të përfunduar për sot.

20 Në qoftë se më lejoni dua që të kërkoj pranimin në provë  
21 materiale të dokumentit të përdorur së fundi.

22 GJYKATËSI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë  
23 kundërshtim?

24 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Jo, nuk kemi kundërshtim.

25 GJYKATËSI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Sandra Mitchell (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Kehoe

Faqe 107

1 SPOE00198307 pranohet. Do t'i caktohet një emër.

2 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Do të marrë numrin e  
3 provës materiale P743.1

4 GJYKATËSI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitare,  
5 vetëm dy seanca kishim për sot. Kështu do të vazhdojmë nesër  
6 prapë në orën 9.00. Znj. Asistente e seancës do ju shoqërojë  
7 jashtë sallës dhe ju rikujtoj që nuk duhet të flisni me askënd  
8 lidhur me dëshminë tuaj përpara Trupit Gjykues.

9 DËSHMITARJA: Në rregull.

10 [Dëshmitarja përfundon dëshminë]

11 GJYKATËSI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mbani  
12 parasysh që siç e thashë edhe më përpara sot mbasdite nuk kemi  
13 seancë, nesër do të takohemi sërish që në orën 9.00

14 Faleminderit për sot dhe shihemi nesër në orën 9.00

15 --- Seanca mbyllet në orën 13.01

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25